



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional
“Administrim Biznesi”, me profile: a. Menaxhim; b. Kontabilitet
- Financë
i
Institucionit të Arsimit të Lartë “Tirana Business University
College”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. Dr. Halit Xhafa

2. Dr. Irma Shyle

Janar 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master Profesional “Administrim Biznesi” me profile: a-Menaxhim, b-Kontabilitet-
Financë

Nr.		
1	IAL aplikues:	Tirana Business University College
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Kontabilitet-Financë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Administrim Biznesi me profile: a-Menaxhim, b- Kontabilitet-Financë
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr.386 datë 05.08. 2011
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë Nr. 3575/3 prot, datë 07.05.2019
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	14/11
18	Numri i studentëve:	86
19	Komente / të tjera:	




TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Përshkrim përmbledhës

Programi i studimit Master Profesional në Administrim Biznesi me profile ofrohet nga, Fakulteti i Administrim Biznesit i TBU me njësi bazë përgjegjëse Departamentin e Kontabilitet-Financë.

Ky raport përshkruan analizën mbi treguesit e matshëm, si dhe shkallën e përmbushjes së standarteve sipas kërkesave të kodit të cilësië dhe nëse programi është në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të TBU. Programi ofrohet me dy profile: Menaxhim dhe Kontabilitet- Financë.

TBU ka ushtruar aktivitetin ekonomik mbeshtetur ne VKM nr.794 date 6.10.2010, me Urdherin e MASH Nr. 75, date 16. 02. 2011. Me vendimin e akreditimit institucional 506 datë 18.7.2013 të Këshillit të Akreditimit të Arsimit të Lartë., me urdhërin e MASH nr.326 datë 15.8.2013 është bërë akreditimi institucional dhe i programeve.

Në zbatim të ligjit 80/2015 datë 22.07.2015, Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë “neni 75 pika 6 u riorganizua programi ekzistues Master Profesional i Avancuar me 90 kredite respektivisht në 60 dhe 120 kredite. Per kete qellim Senati Akademik i TBU me vendimin 33 datë 17.06.2016, u riorganizua perkatësisht në Master Profesional 60 kredite me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë dhe 120 kredite me profile Menaxhim, Kontabilitet-Financë dhe E drejtë Biznesi. Në mbështetje të riorganizimit të programeve u hartuan rregulloret përkatëse, planet dhe programet e studimit.

Realizimi programit mbështetet me infrastrukturën dhe financimin e nevojshëm si dhe me staf akademik me përvojë pedagogjike e akademike dhe profesionale në fushat përkatëse. Afati i studimeve për këtë program është 1 vit. Praktika profesionale organizohet semestrin e dyte.

Ky program studimi e ka origjinen nga programi MP ne "Administrim Biznesi", me profil "Kontabilitet - Finance", "Administrim Biznesi" dhe "E Drejte Biznesi", i licensuar sipas Urdherit te MASH Nr. 386, date 05.08.2011 dhe akredituar me Urdher te MASH Nr. 326, date 15.08.2013. Sipas Vendimit te Senatit Nr. 33, date 17.06.2016 Institucioni i riorganizon keto programe ne Master Profesional Administrim Biznesi me profil; Finance-Kontabilitet, me 120 ects dhe 60 ects, Master Profesional Administrim Biznesi me profil Menaxhim me 120 ects dhe 60 ects dhe Master Profesional Administrim Biznesi me profil E Drejte Biznesi me 120 ects. Pas disa komunikimeve midis TBU dhe MASR mbi riorganizimin e programeve, institucioni paraqiti vendimin e senatit dhe miratimin nga MASR mbi ndryshimin e emertimit te programeve dhe kreditet qe do ti ofrojne konkretisht: Sipas Vendimit te Senatit Nr. 2, date 20.03.2019 dhe miratimit nga MASR me ane te shkreses me Nr. 3575/3 prot, date 07.05.2019, programet/profilet e MP te percaktuar ne Vendimin e Senatit Nr. 33, date 17.06.2016 ndryshojne emertimin si vijon: MP ne "Administrim Biznesi" me profile: i) "Menaxhim"; ii) Kontabilitet-Finance"; Sipas ketij vendimi ky program studimi do te ofrohet me 60 kredite dhe ofrohet nga departamenti i Kontabilitet Finance, Fakulteti i Administrim Biznesit.



Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm

GVJ gjatë vlerësimit të programit është mbështetur në kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë, aktet ligjore dhe nënligjore mbi të cilat funksionon e operon programi, statutet e rregulloret e hartuara e miratuara në TBU, vlerësimin e hapave të bërë dhe progresit të arritur, duke u mbështetur në RVB, rezultatet e vizitës në institucion dhe të dhënat sasiore e cilësore të siguruara gjatë vizitës dhe online ne sistemin AMS të ASCAL, vecanerisht RVB, raportit të NJBSC, anekset dhe tabelat që shoqërojnë e ilustrjnë gjetjet e trajtimet e RVB dhe komentet përkatëse.

GVJ në këtë proces ka vlerësuar programin, përputhjen e tij me objektivat strategjike të njësisë kryesore dhe bazë, kërkesat e tregut, personelin akademik të angazhuar, ndërveprimin e njësisë bazë përgjegjëse me ato mbështetëse, burimet financiare dhe infrastrukturën.

GVJ i përbërë nga Prof. Halit Xhafa dhe Dr. Irma Shyle me asistencën e koordinatorit teknik te ASCAL, në datat 01 dhe 02 Tetor 2020, realizuan vizitat në institucion sipas agjendës së parapërcaktuar.

Më datë 18.12.2020, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 53/22 Prot., datë 18.12.2020, dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. IAL përcolli komentet, përmes AMS, më datë 04.01.2020 dhe me shkresë Nr. 21/11 Prot., datë 04.01.2020.

GVJ pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft raportin, sqaron si vijon:

1. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.1, Kriteri 4 :

GVJ vlerëson partneritetet që ka institucioni me kompani të ndryshme të cilat ofrojnë mundësi intershipi dhe punësimi për studentët. GVJ në draft raportin e dorëzuar, në pjesën e parë të komenteve të bëra për këtë kriter, ka sqaruar se edhe pse nga institucioni konsiderohet si analizë tregu e bërë para hapjes së programit të studimit apo edhe një analizë tjetër e tregut të punës për studentët e diplomuar në vitin akademik 2018-2019, në fakt nuk janë analiza të mirëfillta të tregut të punës. GVJ i qëndrom rekomandimit që institucioni duhet të bëjë një analizë të mirëfilltë të tregut duke u bazuar edhe tek të diplomuarit të punësuar për të bërë përmirësime në programin e studimit. Pavarësisht se në komente, institucioni shprehet se ka opinionin e shume grupeve të interesit në lidhje me programet e studimit, GVJ nuk ka gjetur asnjë informacion të dokumentuar të vënë në dispozicion nga institucioni në lidhje me të.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

2. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.2, Kriteri3:

GVJ , ashtu sikurse edhe në komentin e bërë nga institucioni që programet e studimit i atashohen departamenteve duke synuar afërsinë më të natyrshme të programit të studimit dhe departamentit përkatës, i qëndron argumentit dhe rekomandimit të dhënë në raport për këtë kriter.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

3. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.3, Kriteri 2: GVJ referuar kriterit të shprehur shprehimisht: *Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me*



punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës, evidenton se edhe në bazë të dokumentacionit shtesë të dërguar nga institucioni, komunikimet me punëdhënësit janë vetëm për vende vakante të punës por jo për të marrë vlerësim apo opinion konkret nga punëdhënësit për këtë program studimi. GVJ, vlerëson bashkëpunimin e institucionit me kompani të ndryshme të cilat edhe ofrojnë mundësi punësimi për studentët. Kriteri shprehet për tregun e punës për këtë program studimi dhe jo për tregun e punës në përgjithësi.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

4. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.5. Kriteri 5: GVJ bazuar në komentet sqaruese të GVB si edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni, evidenton se institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

5. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin I.5. Kriteri 6: GVJ bazuar në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni pas dorëzimit të draft raportit në lidhje me komunikimin dhe mundësitë e punësimit të ofruara nga kompani të ndryshme vlerëson përmushjen e këtij kriteri.

Raporti në këtë pikë ndryshon dhe vlerësimi i standardit I.5 ndryshon në përmbushet plotësisht

6. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.1, Kriteri 6:
GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në raport për këtë kriter për të bërë shkrimin e praktikës profesionale me raportin përmbyllës.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

7. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.3, Kriteri 4:
GVJ i qëndron argumentimit të dhënë në raport në lidhje me të gjitha evidentimet dhe sygjerimet e bëra në të për këtë kriter.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

8. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.3, Kriteri 7: GVJ në RVJ është shprehur se përmbajtja e këtij programi studimi programi “nuk ka ndryshuar” për të thënë që nuk ka përmirësime apo përditësime dhe jo sepse kriteri është kuptuar nga GVJ që duhet të ketë ndryshime. GVJ për këtë kriter i ka dhënë argumentet në raport.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

9. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, Kriteri 1: GVJ gjykon se orët jashtë auditorit dhe brenda auditorit duhet të balanconhen. GVJ është dakot me komentin e bërë nga institucioni që për studentët e nivelit master orët jashtë auditorit duhet të jenë më të mëdha. Por për të justifikuar këtë duhet të ketë në planin mësimor dhe në syllabuset e lëndëve më shumë detyra praktike, projekte etj.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



10. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, Kriteri 2: GVJ i qëndron argumentimit të bërë në raport, dhe madje edhe në komentet e bëra nga institucioni, evidentohet se për kategorinë e studentëve që nuk kanë njohuri në fushën e financës dhe kontabilitetit në studimet e tyre të mëparshme, institucioni kryen kurse intensive në lidhje me këto fusha në mënyrë që studentët të marrin njohuritë bazë në këto fusha.

Raporti në këtë pikë ndryshon.

11. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, Kriteri 3: GVJ nuk është shprehur në raport se ndarja e deritanishme e lëndëve në kredite nuk lejon arritjen e objektivave formuese të programit dhe rezultate e pritshme të të nxënit. GVJ i qëndron të gjitha argumentove të dhëna në raport dhe duke ju referuar planeve mësimore gjykon se ndarja në të sipas krediteve sipas leksioneve, seminareve, detyrave të kursit apo projekteve jo vetëm që nuk do ta ngarkonte por do të jepte më shumë informacion për këtë program studimi.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

12. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, Kriteri 4: GVJ bazuar shprehimisht në kriterin: *Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.*, në raport është shprehur se nuk ka gjetur model të njëjtë apo të ngjashëm që ky program studimi i është referuar, që duke ju referuar standardit, nënkupton që nuk ka programe të ngjashme dhe përafërta ndërkombëtare. GVJ është shprehur vazhdimisht në raport që ky program studimi është program i prejardhur nga programi i mëparshëm më të njëjtin emërtim por me 90 kredite.

Referuar vendimit nr. 41, datë 24.01.2018, pika 2.6 shprehimisht thuhet: *Në planin mësimor të cdo programi studimi përcaktohen: i) lëndët e programit të studimit të ndara sipas veprimtarive formuese, si edhe në vite e semestra, ii) kreditet përkatëse.* Për këtë arsye GVJ, është shprehur në raport se kompletimi i planit mësimor sipas veprimtarive formuese me kreditet përkatëse do ta bënte më praktik dhe do të ndihmonte në përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Ndarjet sipas veprimtarive formuese nuk duhet të jenë vetëm në syllabus por edhe në planin mësimor. Kjo do të jepte një pamje më të qartë të programit jo vetëm në dukje por edhe në përmbajtje. Do të ishte më e qartë për departamentin apo kordinatorëve të programit nëse do të kishte nevojë për përmirësime në veprimtarit formuese dhe tek cilat prej tyre.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

13. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.4, Kriteri 9:

GVJ i qëndron rekomandimit të dhënë në këtë kriter. Jo cdo rekomandim i bërë nga GVJ për kriteret nënkupton se kriteri nuk përmbushet.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

14. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.5, Kriteri 1 dhe 2: GVJ nuk ka dhënë mendim personal por duke u bazuar në ligjin e arsimit të lartë sikurse edhe është specifikuar në RVJ. Personeli akademik me gradën Msc nuk mund të angazhohet në mësimdhënie në njohuritë të studimit.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.



15. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.6, Kriteri 1: GVJ për RVJ bazohet në takimet në institucion si edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion. Në lidhje me këtë kriter nuk gjetëm asgjë dokument për të parë dhe gjykuar që ka një opinion dhe vlerësim nga partnerët dhe bizneset e tjera në lidhje me programin e studimit. Në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni janë vetëm emaile komunikimi për punësim nga ana e kompanive, në të cilat edhe shprehen se janë të kënaqur nga bashkëpunimi mëparshëm. Në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni nuk gjetëm asnjë dokument që të dëshmonte se departamentet përgjegjëse për programet e studimit, konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

16. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin II.6, Kriteri 2: GVJ sikurse është shprehur edhe në kriterin e mësipërm bazohet në dokumentacionin e vënë në dispozicion. Përfaqësimi i studentëve në strukturat e institucionit si edhe në GVB është detyrim ligjor.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

17. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin III.3, Kriteri 7: GVJ ka dhënë mendimin dhe vlerësimin për këtë program studimi dhe jo për të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucioni. Ashtu sikurse thuhet nga komentët shtesë të bëra nga institucioni, programi i kontabilitetit i ofruara nga institucioni është kryesisht për studentë e vitit të tretë bachelor të programit Administrim Biznesi dhe jo për studentët e programit të studimit për të cilin GVJ ka hartuar raportin.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

18. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin IV.1, Kriteri 4: GVJ i ka dhënë sqarimet për këtë kriter në raport. Në të gjithë dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni apo edhe gjatë takimit në institucion nuk gjetëm informacion për rekrutimin e stafit akademik PAE dhe PAK, për procedurat e ndjekura etj.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon.

19. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.1, Kriteri 4: GVJ duke u bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni, gjykon se NJSBC ka një plan kalendarik në të cilin të parashikohet plani i veprimit, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.

Raporti në këtë pikë ndryshon. Standarti VI.1 ndryshon nga përmbushet kryesisht në përmbushet plotësisht.

20. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.2, Kriteri 3,4,5 GVJ, bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të dërguar nga institucioni, evidenton se Institucioni i arsimit të lartë nuk përdor mjaftueshëm metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

21. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.3, Kriteri 2, 3,4 GVJ , sikurse edhe është shprehur më sipër, nuk evidenton ndonjë metodë të drejtpërdrejtë, si: vlerësim i



cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës,

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

22. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.4, Kriteri 5, GVJ evidenton se nuk ka asnjë dokumentacion për tju referuar komentit që institucioni ka bërë në lidhje me ekspertët e huaj.

Raporti në këtë pikë nuk ndryshon

23. Për komentin e TBU mbi konstatimin e GVJ në Standardin VI.5, Kriteri 1, GVJ GVJ duke u bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni, gjykon se NJSBC ka një plan kalendarik në të cilin të parashikohet plani i veprimit, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.

Raporti në këtë pikë ndryshon. Standarti VI.5 ndryshon nga përmbushet kryesisht në përmbushet plotësisht.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Administrim Biznesi” me profile: a. Menaxhim, b. Kontabilitet-Financë.

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë i ofruar përkatësisht nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës në Fakultetin e Administrim Biznesit në Kolegjin TBU, është në përputhje me qëllimet, misionin e institucionit dhe strategjinë e zhvillimit të tij. <i>Aneksi 2. TBU Statuti.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU</i> <i>Aneksi 7. Rregullore e programit te studimit mp_ab_60_final</i>
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master Profesional në “Administrim Biznesi” me profilin Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë ofrohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e TBU. GVJ vë në dukje se statuti dhe rregullorja e institucionit theksojnë elementë si: niveli i mësimdhënies, kërkimi shkencor, specializimi i stafit, etj dhe realizimi i këtij programi studimi mbështetet në këto pika të cilat vënë në dukje ruajtjen e cilësisë. <i>Aneksi 2. TBU Statuti.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU</i>
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Bazuar në shqyrtimin e dokumentacioneve si dhe përgjatë vizitës së zhvilluar në IAL grupi i vlerësimit të jashtëm vuri re se programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore dhe njësisë bazë që e ofron këtë program studimi. <i>Aneksi 2. TBU Statuti.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i>
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion, GVJ konstaton se për hapjen e këtij programi studimi nga institucioni është zhvilluar një analizë tregu në formën e një Plan Biznesi i dorëzuar përpara hapjes në MAS ne vitin 2010. Kjo analizë përmban më tepër një analizë të tregut të arsimit të lartë si edhe një analizë SËOT të institucionit. Sipas kësaj analize, numri i gjimnazistëve që përfundojnë studimet e tyre do të rritet duke rritur kështu edhe mundësinë e institucioneve private të arsimit të lartë për ti përthithur këta gjimnazistë duke u bazuar edhe në kushtet dhe infrastrukturën e ofruar prej këtyre institucioneve. Gjithashtu, në vitin 2020, nga institucioni është realizuar një analizë tjetër e tregut të punës për studentët e diplomuar në vitin akademik

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>2018-2019 për të parë nëse studentët e diplomuar janë të punësuar apo jo dhe sa prej tyre janë të diplomuar në profilin e tyre të studimeve. Sipas këtij studimi rezulton se pjesa më e madhe e studentëve (93%) të diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në programin e studimit MP në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, janë të punësuar në përputhje me profilin e programit të studimit që ata janë diplomuar.</p> <p>GVJ konstaton se kjo analizë nuk është mbështetur në kërkesat dhe pritshmëritë e bizneseve apo në opinionin e bizneseve dhe studentëve të diplomuar se çfarë vështirësi shohin ata në tregun e punës bazuar në programin e studimit që ata kanë përfunduar.</p> <p><i>GVJ sygjeron që nga institucioni të bëhet një analizë më e saktë dhe e kompletuar duke u bazuar në figurën që kompanitë duan dhe kanë nevojë për të punësuar dhe që nuk mundën ta gjejnë në tregun e punës. Një studim i tillë do të ndihmonte për të përmirësuar planin mësimor duke e ndryshuar dhe e përshtatur me nevojat e tregut.</i></p> <p><i>Aneks 16. Analiza e tregut të punës para hapjes</i> <i>Aneks 17. Studimi për tregun e punës, Janar 2020</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2	
Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit në nivel institucional, konstatohet nga ana e GVJ se programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, është konceptuar në harmoni me strategjitë e institucionit. Ai është konform objektivave strategjike për zhvillimin, gjithashtu, organizimi i këtij programi është bërë në përputhje me statutin e institucionit.</p> <p><i>Aneks 2. TBU Statuti</i> <i>Aneks 3.1. Strategjia e zhvillimit të TBU</i></p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentave strategjike të TBU-së, (<i>Statuti, Strategjia e Zhvillimit, Rregullorja e Institucionit për programet e studimit si dhe Departamentit</i>) si dhe nga vizita në institucion, GVJ arrin në përfundim se: organizimi i këtij programi studimi, është bazuar në dokumenta strategjike që orientojnë misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit.</p> <p><i>Aneks 3.1. Strategjia e zhvillimit të TBU</i></p>
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, ofrohet nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës, pjesë e Fakultetit të Administrim Biznesit në TBU. Ky program studimi ofrohet në dy profile: Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë. Pavarësisht lëndëve të përbashkëta në të dy</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>profilet, profilet dallojnë për figurën e studentit profesionist që ato krijojnë. Për këtë arsye, GVJ konstaton se ky program studimi, me profilin Kontabilitet-Financë është në përputhje të plotë me drejtimin akademik dhe fushat prioritare të Fakultetit të Administrim Biznesit dhe të Departamentit të Kontabilitet-Financë që është përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p><i>Ndërsa për profilin Menaxhim, GVJ sygjeron që, mund ti atashohet si program studimi Departamentit të Menaxhimit duke qenë në përputhje të plotë me drejtimin akademik të këtij departamenti.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Programi i studimit MP në “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, është hartuar në përputhje të plotë me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit. GVJ gjykon që programi i studimit përputhet me nevojat aktuale lokale dhe globale në fushën e menaxhimit dhe kontabilitetit-financës.</p> <p><i>Aneks 3.1. Strategjia e zhvillimit të TBU</i> <i>Aneksi 7. Rregullore e programit të studimit, MP 60 ECTS</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi I.3 Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfaqësojnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Ky program ka të përcaktuar qartë objektivat e formimit të studentëve, kompetencat dhe njohuritë që studenti duhet të ketë në hyrje të programit dhe në dalje të tij.</p> <p>Programi është projektuar për studentët që kanë përfunduar një program studimi universitar prej së paku tre vitesh (bachelor), brenda apo jashtë vendit sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentët me transferim.</p> <p>Ky program studimi synon të përgatisë në kohë të shkurtër profesionistë në fushën e menaxhimit dhe kontabilitetit-financës të aftë të marrin përsipër menaxhimin dhe drejtimin në subjekte të ndryshme biznesi, por dhe në sektorë të tjerë, si sektori publik dhe sektori jofitimprurës.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfaqësojnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës,</p>	<p>Nga të dhënat e vendosura në dispozicion grupi i vlerësimit të jashtëm nuk konstaton ndonjë planifikim për analizimin e tregut dhe ndryshimet që mund të ndodhin në të, në periudha të ndryshme kohore.</p> <p>Studimi për hapjen e këtij programi studimi është mbështetur në mundësitë e studimit por pa patur asnjë studim konkret të tregut për domosdoshmërinë e këtyre profileve, të të diplomuarve në këtë program studimi. Nuk ka asnjë studim tregu për të parë sfidat dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>vështirësitë që mund të kenë të diplomuarit në programin e studimit Master Profesional 60 Ects, krahasuar programin Master Professional 120 Ects, në tregun e punës. Madje edhe studimi i bërë në vitin 2020 (Aneksi 17) është vetëm një studim për të parë raportin e të diplomuarve dhe të punësuarve por nuk ka studim duke marrë në konsideratë mendimin, opinionin apo sygjerimet e kompanive apo institucioneve ku këta studentë janë punësuar.</p> <p><i>GVJ konstaton se në evidenca nuk paraqiten komunikime zyrtare me punëdhënësit të fushës sipas këtij programi studimi.</i></p> <p><i>Aneks 16. Analiza e tregut të punës përpara hapjes</i> <i>Aneks 17. Studimi për tregun e punës, Janar 2020</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i përmbajtjes së programit të studimit, GVJ konstaton se objektivat formuese dhe struktura e programit të studimit, orientohen kah nevojave të konstatuara në tregun e punës. GVJ nga takimi me përgjegjësin e departamentit dhe njëherazi edhe me koordinatorin e këtij programi studimi, konstatoi që programi i studimit është hartuar në përputhje me kompetencat e nevojitura nga biznesi. Synimi i institucionit për këtë program studimi është të ketë një nivel mbi 75% të studentëve para diplomimit të tyre. Sipas një studimi të bërë në vitin 2020, rezulton se pjesa më e madhe e studentëve (93%) të diplomuar në vitin akademik 2018-2019 në programin e studimit MP në “Administrim Biznesi” me profile: Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, janë të punësuar në përputhje me profilin e programit të studimit që ata janë diplomuar.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Referuar RVB dhe takimeve në institucion GVJ konstaton se ky program studimi është risi edhe për kohën e shkurtër të periudhës së studimit.</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, ka të pasqyruar përmbajtjen e detajuar dhe është vlerësuar në kredite Evropiane sipas sistemit ECTS. Diploma që jepet në përfundim të programit të studimit Master Profesional, shoqërohet me suplementin e diplomës, programi i studimit është i organizuar në module të vlerësuara në kredite, në përputhje me Sistemin Europian të Transferimit të Krediteve dhe në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi (L. 80/2015 dhe VKM Nr.41 datë 24.01.2018). Ky program është i organizuar në: lëndë bazë të detyrueshme, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore dhe detyrime përmbyllëse.</p> <p>Programi ofrohet me kohë të plotë me kohëzgjatje normale 1 vit akademik ku studentët përftojnë 60 kredite ECTS (24 kredite në semestrin e parë dhe 36 kredite në semestrin e dytë).</p>
<p>Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me</p>	<p>Referuar Planit Strategjik të institucionit, GVJ informohet se institucioni në vizionin e tij e vë theksin në formimin dhe përgatitjen e studentëve, duke krijuar mundësi për përvetësimin e njohurive specifike teorike duke i ndërthurur me aspektin praktik. Programi i</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, ka të parashikuar praktikën profesionale në semestrin e dytë, prej 6 kreditesh në një periudhë kohore jo më pak se 5 javë. Studentët e punësuar në profilin e programit të studimit, u njihet koha e tyre e punësimit si praktikë profesionale. Studentët që nuk janë të punësuar ose janë të punësuar por jo në profilin e programit të studimit e kanë të detyrueshme kërren e praktikës profesionale në kompanitë e përcaktuara nga institucioni. Në fund të praktikës profesionale studentët paraqesin relacionin e praktikës, të cilin e dorëzojnë paraprakisht dhe e prezantojnë para një komisioni dhe për të cilin ata vlerësohen me notë. Prgatitja e relacionit të praktikës është 6 kredite.			
Kriteri 7. Në varësi të profilit të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, zhvillohet në gjuhën shqipe.			
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësimit të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, përmbush plotësisht këtë kriter sepse është hapur në funksion të plotësimit të nevojave në një drejtim të caktuar të biznesit. Ky program studimi ndiqet nga studentë të TBU që kanë përfunduar ciklin e studimit Bachelor edhe nga individë të punësuar në biznese të cilat kanë nevojë për njohuritë e ofruara nga ky program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4	
Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Fakulteti i Administrim Biznesit dhe më konkretisht Departamenti i Kontabilitet-Financës, ofrojnë programin e studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, si struktura përgjegjëse për këtë program studimi, plotësojnë kriteret ligjore sipas marrëveshjes që TBU ka nënshkruar MASR, në lidhje me numrin e personelit akademik si dhe të titujve/gradave shkencore. Stafit akademik i aktivizuar është në përputhje me fushën e programit të studimit dhe me eksperiencë relativisht të gjatë akademike.
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë	Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, është program studimi i ciklit të dytë të studimit, referuar nivelit të 7 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, organizohet me 60 kredite Europiane dhe kohëzgjatje

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>normale 1 vit akademik, në përputhje me nenin 70 pika 4 e Ligjit 80/2015. Ky është një program i fushës së financës, kontabilitetit dhe menaxhimit i cili ofrohet nga Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës. Mes fushës së përgjithshme dhe specifike të programit të studimit dhe fushës akademike e kërkimore të njësisë kryesore që është përgjegjëse për ofrimin e programit, konstatohet se ka përputhshmëri.</p> <p>Ky program studimi mund të zhvillohet në vijim të programeve të tjera të studimit që ofrohen në ciklin e parë të studimeve Bachelor nga Fakulteti i Administrim Biznesit por jo vetëm.</p> <p><i>Aneksi 36. Vendim per emerimin e koordinatorëve te programeve MP AB.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, është i atashuar pranë Departamentit të Kontabilitetit dhe Financës. Por për lëndët më natyrë manaxheriale dhe disiplina të tjera, angazhohen në mësimdhënie staf akademik nga Departamenti i Menaxhimit si edhe nga Departamenti i Lëndëve të përgjithshme që janë pranë Fakultetit të Administrim Biznesit.</p> <p><i>Aneksi 36. Vendim per emerimin e koordinatorëve te programeve MP AB.</i></p> <p><i>Aneksi 20. CV Stafit Akademik Programi MP AB 60 ECTS.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, është tërësisht në drejtimin specifik brenda profilit të institucionit.</p> <p><i>Aneksi 2. TBU Statuti.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentave si: (<i>Aneks 5. Rregullore e Institucionit-TBU, Aneks 6. Rregullore njësisë bazë, Aneks 7. Rregullore e programit të studimit MP, Administrim Biznesi 60 kredite</i>), GVJ konstaton se ka një ndarje të detyrave dhe përgjegjësisë mes strukturave të institucionit, dhe pesha kryesore për programin e studimit mbulohet nga njësia bazë përgjegjëse, Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës. Programi i studimit Master Profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




tyre.	ka në përbërje të tij module të cilat ofrohen nga Departamenti i Menaxhimit si edhe nga Departamenti i Lëndëve të përgjithshme nga Fakulteti i Administrim Biznesit.			
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Nga diskutimet e kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton se me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor të programit të studimit Master Profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, institucioni është në bashkëpunim të plotë me biznesin duke krijuar mundësinë e kryerjes së praktikave profesionale si edhe duke krijuar mundësi për punësim për studentët apo të diplomuarit.			
Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Bazuar në RVB si edhe gjatë takimit që GVJ pati me drejtuesit e institucionit sikurse edhe me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit Master Profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, u evidentua se në nivel institucional kishte shumë marrëveshje bashkëpunimi kryesisht me kompani private në vend, të cilat siguronin edhe zhvillimin e praktikës profesionale.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.	<p><i>Aneks: TBU_RVB_Programi_Master_Profesional_AB_60.</i></p> <p><i>Aneks 32. Tabele permbledhëse Institucionet bashkepunuese.</i></p> <p><i>Aneks 34. TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme.</i></p> <p><i>Aneks 35. Raporti periodik perfitimi marreveshje bashkepunimi.</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Gjatë takimit që GVJ pati me drejtuesit e institucionit si edhe me studentët e programit të studimit, si edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ evidenton se studentët e diplomuar ftoheshin vazhdimisht të merrnin pjesë në seminarët apo në leksionet e hapura të ofruara nga stafi akademik i TBU apo lektorë të ftuar.			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	<p>Në RVB (<i>Aneksi 35</i>) paraqitet në mënyrë të përmbledhur përfitimi nga marrëveshjet e bashkëpunimit e cila konsiston në praktikat profesionale, intership si edhe në punësimin e studentëve apo të diplomuarve në këtë program studimi.</p> <p>Bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni në lidhje me komunikimet zyrtare me kompani të ndryshme në lidhje me mundësitë e intershipit dhe punësimit, GVJ evidenton dhe vlerëson institucionin për krijimin e mundësive të punësimit të studentëve apo të të diplomuarve.</p> <p><i>Aneks 35. Raporti periodik përfitimi marrëveshje bashkëpunimi.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




			X	
--	--	--	----------	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni konfirmohet që programi i studimit Master Profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, përputhet plotësisht me kriteret e caktuara dhe aktet nënligjore në fuqi, i cili është me kohëzgjatje 1 vit akademik, 60 ECTS. Ky program është ndërtuar në respekt dhe zbatim të ligjit për arsimin e lartë si dhe aktet e tjera të legjislacionit vendas në fuqi dhe gjithashtu sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) për të pasur një pajtueshmëri të plotë me to.</p> <p><i>TBU_RVB_Programi_Master_Profesional_AB_60.</i> <i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_mp_ab_60_final</i> <i>Aneksi 14.1_Plani_mesimor_Master_Profesional_AB_19-20.</i></p>
Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	<p>Hartimi dhe përditësimi i programit Master Profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, është realizuar sipas nevojave të tregut. Për të realizuar këtë qëllim, në RVB por edhe gjatë vizitës u konstatua se njësia bazë mban lidhje të ngushta me sektorin privat të punësimit, që kanë fokus kryesor fushën e kontabilitetit, financës dhe menaxhimit për të siguruar përputhshmërinë e programit të studimeve me nevojat e tregut. Studimi i tregut dhe kuptimi i nevojave aktuale, janë përcaktues të kërkesave për prurje profesionale të fushave të kontabilitetit, financës dhe menaxhimit. IAL ofron kuadër profesional të fushave përkatëse të cilët mund ti shërbejnë kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Gjatë takimit që GVJ pati me drejtuesit e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, u konstatua se synimi është që studenti të preferohet në vendin e punës. Madje sipas tyre, studentët e këtij programi studimi nuk e diskutojnë punësimin por synohet inovacioni dhe promovimi në karrierë.</p> <p><i>TBU RVB Programi Master Profesional_AB_60.</i></p>
Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	<p>Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, synon aftësimin e studentëve në trajtimin e situatave të ndryshme në një mjedis që është sa i paparashikueshëm aq edhe fleksibël.</p> <p>Ky program studimi synon në përgatitjen për një kohë të shkurtër, pra për një vit të profesionistëve në këtë fushë.</p> <p><i>Aneksi 7. Rreg progr stad mp ab 60_final.</i> <i>Aneksi 38_Analize e realizimit te objektivave Programi Studimit Master Profesional 60 Ab_18-19.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë i ofruar nga Fakulteti i Administrim Biznesit synon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përgatisë studentët me njohuri teorike dhe praktike shumë të specializuara, në nivele të avancuara dhe bashkëkohore në fushën e administrimit të biznesit, të aftë të bëjnë analizë kritike të dijeve të mara. • t’ju ofrojë studentëve njohuri të avancuara dhe bashkëkohore dhe t’ju mundësojë atyre aftësimin në profilet e menaxhimit, e kontabilitetit dhe atë të financave si edhe të drejtës së biznesit, të nevojshme për menaxhimin e shëndoshë të biznesit. • të përgatisë studentët me aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që hasen gjatë administrimit të një biznesi privat, apo në sektor publik dhe jo vetëm. • të kenë aftësi të zgjidhin probleme që kanë lidhje me kërkimin, zhvillimin apo inovacionin për të mbështetur operacionet e reja të biznesit, si edhe për të fituar pjesë të tregut. • të jenë kompetentë të kryejnë transformime thelbësore në pozicionet e punës ku punojnë, tju japin drejtim situatave të paparashikueshme duke gjetur zgjidhje strategjike për subjektet ku aktualisht kryejnë praktikën profesionale apo janë të punësuar. <p>Sipas drejtuesve të departamenteve, objektivi kryesor është që studentët që ndjekin këtë program studimi të ngjiten një shkallë më lartë në karrierë përpara përfundimit të studimeve.</p> <p><i>Aneks 7. Rregullore e programit të studimit, MP 60 ECTS</i></p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.80/2015 (neni75). Ky program studimi ofrohet me 60 ECTS, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik dhe me dy semestra.</p> <p>Referuar RVB studimet përmbillen me provim përfundimtar ose temë diplome, ngarkesa e të cilës është 6 kredite, dhe është parashikuar 100% studim individual.</p> <p><i>TBU_RVB_Programi_Master_Profesional_AB_60.</i></p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit i ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe ngarkesën përkatëse në kredite.</p> <p>Programi është përcaktuar konform përcaktimit në shtojcën 1 të VKM Nr. 41 datë 24.01.2018. Studeni merr:</p> <p>Në kategorinë A (6 kredite);</p> <p>Në kategorinë B (24 kredite);</p> <p>Në kategorinë C (12 kredite);</p> <p>Në kategorinë D (6 kredite);</p> <p>Në kategorinë përmbyllëse E (12 kredite);</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>GVJ konstaton se në kategorinë përmbyllëse E, në planin mësimor të programit është vendosur edhe raporti i përvojës profesionale 6 kredite. Sipas VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, pika 2.5, V, thuhet: <i>Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar.</i></p> <p><i>GVJ sygjeron rishikimin e planit mësimor për kategorinë përmbyllëse E.</i></p> <p><i>Raporti i përvojës profesionale mund të shkrihet me Praktikën profesionale. Në fund të praktikës profesionale studenti përgatit relacioni e praktikës të cilin e dorëzon dhe e prezanton para një komisioni, dhe kjo mund të konsiderohet si detyrim për tu shlyer për praktikën profesionale.</i></p> <p><i>Aneksi 14.1_Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i></p>			
<p>Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale sipas përcaktimeve në VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 ku praktika profesionale duhet të ketë 10% kredite.</p> <p>Referuar planit mësimor praktika profesionale ka një peshë rreth 10 % të të gjithë programit të studimit. Praktika profesionale ka 6 kredite me një angazhim prej 150 orësh për studentin.</p> <p><i>Aneksi 14.1.Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore në kuadër të marrëveshjes që TBU ka nënshkruar me MASR për personelin akademik, për vlerësimin dhe akreditimin. Gjithashtu, edhe njësia bazë që është Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës e zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të marrëveshjes së sipër përmendur.</p> <p>Grupi i vlerësimit të brendshëm përbëhet nga anëtarë të personelit akademik efektiv të departamentit dhe një përfaqësues i studentëve të këtij program studimi.</p> <p><i>Aneksi 5_Rregullore e Institucionit_TBU.</i> <i>Aneksi 6_Rregullore njësisë bazë_TBU.</i> <i>TBU_RVB_Programi_Master Profesional_AB_60(perditesuar)</i> <i>Aneksi shtese 06_Mareveshja MASR_TBU_percaktimi_personaleti_akademik.pdf.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Fakulteti i Administrim Biznesit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, sipas marrëveshjes që TBU ka lidhur me MASR (<i>Aneksi shtese 06_Mareveshja MASR_TBU_percaktimi_personaleti_akademik.pdf</i>). Ky fakultet, ka në përbërje 3 departamente te cilat sherbejne per programet e studimit te ketij fakulteti.Të dhënat për vitin akademik 2019-2020 janë si më poshtë:</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Departamenti i Kontabilitet-Financës, i cili ka 6 PAE, nga ku 3 grada/tituj dhe 7 PAK; - Departamenti i Menaxhimit, i cili ka 10 PAE, nga ku 4 me tituj/grada dhe 10 PAK; - Departamenti i Lëndëve të përgjithshme , i cili ka 13 PAE, nga ku 3 me grada/tituj dhe 3 PAK;
<p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Stuktura, detyrat dhe përgjegjësitë e njësisë kryesore dhe asaj bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi, janë të përcaktuara në statut dhe në rregulloren e Fakultetit, të cilat janë në përputhje me Ligjin 80/2015 të Arsimit të Lartë. Dekani i Fakultetit mban titullin akademik “Profesor i Asociuar” ndërsa Përgjegjësi i Departamentit ka gradën shkencore, “Doktor i Shkencave”</p> <p>Përsa më sipër GVJ konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë plotësojnë detyrimet ligjore për nivelin e kualifikimit të personelit akademik.</p> <p><i>Aneksi 23. Te dhena Tabelore pers.akad. njesia kryesore_njesia pergjegjese.</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.</p>	<p>GVJ nga vizita në institucion por edhe nga dokumentacioni i depozituar, konstaton se njësia kryesore dhe ajo bazë përgjegjëse për programin e studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, angazhon vetëm personelin akademik efektiv për udhëheqjen dhe realizimin e praktikave, nisur edhe nga numri i vogël i deritanishëm i studentëve. GVJ konstatoi nga takimi me studentët, se institucioni angazhon personel akademik efektiv, të cilët asistojnë studentët si dhe lehtësojnë përmbushjen e këtyre detyrimeve.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Aneks shtesë 05. Vendim përcaktimi drejtuesve praktikës mësimore 2018-2019.</i>) për këtë program studimi rezultoi 1 staf akademik efektiv nga departamenti përkatës si udhëheqës i praktikës profesionale.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Programi i studimit, Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, ka të përcaktuar koordinatorin e programit. (<i>Aneks shtesë 05. Vendim përcaktimi drejtuesve praktikës mesimore 2018-2019</i>)</p> <p>Nga informacioni i siguruar nga RVB si dhe nga vizita në institucion, rezultoi se koordinatori i këtij programi studimi, është përgjegjësja e Departamentit të Kontabilitet-Financë. Koordinatori është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</p>
<p>Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te</p>	<p>Koordinatorin e programit, në këtë rast edhe Përgjegjësi i Departamentit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




drejtuesi i njësies përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	të Kontabilitet-Financë, bën analizë vjetore për ecurinë e këtij programi studimi dhe përmbushjen e objektivave në lidhje me të dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit, me qëllim adresimin zgjidhjen e problematikave të identifikuar për të ardhmen. (Aneks 38. Analize e realizimit të objektivave Programi Studimit Master Profesional 60 Ab_18-19.)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për programin e studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, Fakulteti i Administrim Biznesit dhe Departamenti i Kontabilitet-Financë, përgjegjës për këtë program studimi, kanë informacionin e duhur për organizimin e këtij masteri, si rregullorja e programit, plani mësimor, shpërndarja e lëndëve sipas pedagogëve. Referuar planit mësimor, konstatohet se programi është i organizuar në lëndë, të ndara sipas kategorive që përmban VKM Nr.41. <i>Aneksi 7. Rreg_progr_stud_mp_ab_60_final.</i> <i>Aneksi 14.1. Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i> <i>Aneksi 25. Te dhena tabelore ngarkesa e plote stafi akademik.</i>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket si dhe numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur lënda zhvillohet. Kohështrirja e programit është një vit akademik me dy semestra. Studenti në përfundim merr 60 kredite ECTS. <i>Aneksi 7. Rreg_progr_stud_mp_ab_60_final.</i>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Gjatë vizitës në institucion si dhe nga dokumentacioni i depozituar në sistemin AMS, GVJ konstatoi se për programin e studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, njësia kryesore dhe ajo bazë kanë informacionin e duhur për organizimin e këtij masteri, si rregullorja e programit, plani mësimor dhe shpërndarja e lëndëve sipas pedagogëve. Referuar planit mësimor, konstatohet se programi është i organizuar në lëndë, të ndara sipas kategorive që përmban VKM Nr.41. Programi i studimit, për çdo lëndë ka të përcaktuar kategorinë të cilës i përket si dhe numrin e krediteve sipas sistemit ECTS, vitin dhe semestrin kur lënda zhvillohet. Kohështrirja e programit është një vit akademik me dy semestra. Studenti në përfundim merr 60 kredite ECTS. <i>Aneksi 7. Rreg_progr_stud_mp_ab_60_final.</i> <i>Aneksi 14.1. Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i>
Kriteri 4. Programet e studimit	Referuar dokumentit (<i>Aneks 14.1. Plani mesimor Master Profesional AB</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>19-20.), konstatohet se ka informacion për ndarjen e cdo lënde në komponentët leksion/seminar por vetëm i shprehur në ngarkesë orë javore dhe jo sipas krediteve sipas veprimtarive. Kështu mungon në planin mësimor ngarkesa e shprehur në kredite për detyrat e kursit apo projektet, ndërkohë që në syllabuset e lëndës thuajse të gjitha lëndët kanë në përmbajtje të tyre, si pjesë e detyrimeve dhe vlerësimit të studentëve, detyra kursi apo projekti.</p> <p>Në planin mësimor përcaktohen orët në auditor/jashtë auditorit. Ajo që GVJ evidentoi duke parë planin mësimor përse i përket orëve në auditor dhe jashtë auditorit ishte një disbalancë midis tyre, konkretisht 420 orë në auditor dhe 1080 orë jashtë auditorit.</p> <p>Pavarësisht se në VKM nr. 41 datë 24.1.2018, pika 2.1/ç citohet se orët për punë të pavarur të studentit zënë jo më pak gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve mësimore vjetore, <i>GVJ sgjeron se në planin mësimor duhet të rishihet kjo ndarje.</i></p> <p>Duke u bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni për këtë program studimi, vihet re një fleksibilitet në planin mësimor për cdo vit. Konkretisht, në rregulloren e programit të studimit (Aneks 7), lënda e vetme që mbetet e pandryshuar cdo vit akademik, është lënda bazë (A), Sjellje Organizative dhe Lidërsip. Të gjitha kategoritë e tjera të lëndëve janë të listuara përkatësisht kategoria B-11 lëndë me përkatësisht 6 kredite secila nga të cilat do të përcaktohen vetëm 4 lëndë, kategoria C-9 lëndë me përkatësisht 6 kredite secila nga të cilat do të përcaktohen vetëm 2 lëndë.</p> <p>Plani mësimor, përcaktohet në fillim të cdo viti akademik. Pasi përcaktohet në departament, kalon në dekanat, në rektorat e më pas në senatin akademik për tu miratuar, mbështetur mbi bazën ligjore për nivelin e krediteve. (Aneks 07. <i>Procesi i vendimarrjes së planit mësimor 19-20</i>). Duke qenë se plani mësimor në senatin akademik, cdo vit akademik, nuk ndryshon vetëm në masën 20% sikurse edhe ligji parashikon por me 36 kredite (përfshijto lëndën bazë që është e pandryshueshme, praktika profesionale, relacioni i praktikës dhe diploma ose provimi përfundimtar), <i>GVJ nuk mund të gjykojë nëse studentët që kanë përfunduar të njëjtin program studimi, në vite të ndryshme akademike, kanë marrë të njëjtat dije apo aftësi.</i></p> <p>Referuar dokumentit (Aneksi 5. <i>Rregullore e Institucionit TBU</i>), rezulton se janë të parashikuara dhe të përcaktuara mënyrat e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit. Kontrolli i dijes për studentët, realizohet nëpërmjet vlerësimit semestral. Skema e vlerësimit për çdo komponent të kontrollit të dijes përcaktohet në syllabus. Kështu në shumicën e lëndëve elementët e skemës së vlerësimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në leksione dhe aktivizimi në seminare - Kontrolli i ndërmjetëm - Detyra e kursit - Provimi përfundimtar <p>Në rregulloren e programit të studimit (Aneksi 5. <i>Rregullore e</i></p>
--	---

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>Institucionit_TBU), neni 16, thuhet: Për provimin përfundimtar disponohen, si rregull 60 pikë dhe për kontrollet pararendëse së bashku 30 pikë por, në syllabusin e lëndës mund të parashikohet edhe një raport tjetër duke rritur peshën e pikëve për kontrollet pararendëse por jo më shumë së 50 pikë gjithësej.</i></p> <p>GVJ duku ju referuar syllabuseve konstaton se në një pjesë të mirë të tyre ky nen i rregullores nuk zbatohet. Psh Menaxhimi Strategjik, provimi final 40%; Sjellje Organizative dhe Liderhip nuk ka provim përfundimtar; Kontabilitet Manaxherial i Avancuar 35%,; Drejtim Financiar i Avancuar 40 %;etj.</p>			
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ duke ju referuar rregullores së institucionit, konstaton se TBU ofron mundësi për transferimin e studimeve në përputhje me legjislacionin në vend. Në vlerësimin e krediteve të transferueshme TBU merr parasysh çdo dije dhe shpreh të fituar nga studenti në programet e mëparshme e që janë të krahasueshme me programin në të cilin kërkohet transferimi. Vendimi për njohjen e krediteve dhe të programit që duhet të ndjekë studenti në TBU në përputhje me legjislacionin merret nga komisioni perkatës i ngritur nga njësia bazë përkatëse.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit shoqërohet me syllabuset e çdo lënde. GVJ nga shqyrtimi i syllabuseve, konstaton se në këto syllabuse ka informacion për objektivat, për literaturën, për format e organizimit, mënyrën e vlerësimit etj. GVJ konstaton se Syllabuset e lëndëve janë organizuar duke pasur në përmbajtje, objektivat, temat, literaturën bazë dhe ndihmëse, emrin e titullarit, numrin e krediteve si dhe ngarkesën leksion seminar. Modeli që përdoret për hartimin e tyre, është bazuar në modelin e përcaktuar në <i>VKM nr. 41, Dt.24.01.2018 (Pika 2.8, shtojca nr.2).</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion dhe takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe asaj bazë përgjegjëse, rezulton se përmbajtja e këtij programi studimi, nuk ka ndryshuar kjo për shkak të kohës së shkurtër pas riformatimit të masterit me 90 kredite.</p> <p><i>Por GVJ rekomandon që plani mësimor në të ardhmen, t'i nënshtrohet në mënyrë të vazhdueshme ndryshimeve, me qëllimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore por edhe me kërkesat e një tregu pune dinamik si dhe për të reflektuar edhe rekomandime të ekspertëve të jashtëm, apo të studentëve si dhe të bizneseve partnere.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi është në përputhje të plotë me nenin 75, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë, Nr 80/2015. Në bazë të kësaj pike përcaktohet se programet master profesional organizohen me 60 ose me 120 kredite dhe kohëzgjatja e tyre është një vit ose dy vite akademike.</p> <p>Programi i studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 60 Kredite; - Orë total 1500, 420 orë në auditor/1080 orë jashtë auditorit; - Semesti i parë ka 600 orë, 240 orë në auditor, 360 orë jashtë auditorit; semestri i dytë ka 900 orë, 180 orë në auditor dhe 720 orë jashtë auditorit. - 8 Orë leksion dhe 8 orë seminar semestri pare (15 jave), dhe 6 orë leksion dhe 6 orë seminar semestri i dytë (15 jave); <p><i>GVJ është e mendimit se ngarkesa e programit të studimit duhet rishikuar për të balancuar orët në auditor dhe jashtë auditorit.</i></p> <p><i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_mp_ab_60_final.</i> <i>Aneksi 14.1_Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ është e mendimit se programi ka përputhshmëri, midis emërtimit të tij dhe lëndëve që përmban, të cilat do të mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme si dhe për punësimin e studentëve që vazhdojnë këtë program studimi në përputhje me emërtesën e programit të studimit. Shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve. Ai synon të plotësojë nevojat e tregut të punës për specialistë në fushën e kontabilitetit, financës dhe menaxhimit.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ, duke shqyrtuar edhe programet e studimit të mëparshme bachelor për studentët e regjistruar në këtë program studimi evidenton se ky program studimi është shumë i thelluar për studentët që kanë përfunduar programet bachelor në: Drejtësi, Kimi, Gjuhët e Huaja, Inxhinieri etj (Aneks S.1). Për këtë kategori studentësh që nuk kanë njohuri e dije të mëparshme në fushën e ekonomisë, financës dhe kontabilitetit, GVJ gjykon se është e vështirë që studenti të përvetësojë koncepte të thelluara në lëndë si: Kontabilitet Manaxherial i Avancuar, Drejtim Financiar i Avancuar, Menaxhim i Riskut Financiar etj. Por sipas institucionit, në komentët shtesë të bëra prej tyre, për këtë kategori studentësh që nuk kanë njohuri në fushën e financës dhe kontabilitetit, institucioni organizon kurse intensive, pa pagesë në mënyrë që këta studentë të fitojnë njohuritë bazë në këto fusha.</i></p> <p><i>Aneksi 14.1_Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i> <i>S.1_Lista me background-in e studentëve të MP (nga cili program bachelor vijnë).</i></p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë</p>	<p>Ky program ka për qëllim t’u mësojë studentëve kombinimin e dijeve teorike me aftësi konkrete, si dhe aftësinë për të zbatuar në praktikë konceptet teorike, në mënyrë që të jenë të aftë të përshtaten, të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional.</p>	<p>orientohen, dhe të kenë sukses në dinamikat komplekse të tregut të lirë. <i>GVJ gjykon se plani mësimor duhet të jetë i organizuar në një mënyrë që edhe ndarja e krediteve sipas lëndëve të bëjë dallimin se cilat janë lëndë bazë apo karakterizuese. GVJ sygjeron që lëndët që janë tipike të programit të studimit të kenë më shumë kredite se lëndët e tjera apo ato me zgjedhje. Gjithashtu Raporti i përvojës profesionale duhet të shkrihet me praktikën profesionale, duke mundësuar kështu shtimin e një lënde tjetër me 6 kredite.</i></p> <p><i>GVJ gjykon gjithashtu se duke qene nje program master profesional, lëndët në përmbajtje të tyre dhe të shprehura edhe në planin mësimor të kenë detyra kursi apo projekte në varësi të lëndëve. Kjo gjë shprehet në syllabuset e lëndëve si detyrime dhe vlerësime për lëndën por jo në planin mësimor me kredite përkatëse.</i></p> <p><i>Plani mësimor në varësi të veprimtarive formuese duhet të shprehet jo vetëm në orë mësimore në javë për lëksion dhe seminar por edhe në kredite.</i></p> <p><i>Aneksi 7_Rreg_progr_stud_mp_ab_60_final.</i> <i>Aneksi 38_Analize e realizimit te objektivave Programi Studimit Master Profesional 60 Ab_ 18-19.</i> <i>Aneksi 14.1_Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Referuar dokumentacionit (Aneksi 7), objektivat e kërrij programi studimi janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përgatisë studentët me njohuri teorike dhe praktike shumë të specializuara, në nivele të avancuara dhe bashkëkohore në fushën e administrimit të biznesit, të aftë të bëjnë analizë kritike të dijeve të mara. • T’ju ofrojë studentëve njohuri të avancuara dhe bashkëkohore dhe t’ju mundësojë atyre aftësimin në profilet e menaxhimit, e kontabilitetit dhe atë të financave si edhe të drejtës së biznesit, të nevojshme për menaxhimin e shëndoshë të biznesit. • Të përgatisë studentët me aftësi të specializuara për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që hasen gjatë administrimit të një biznesi privat, apo në sektor publik dhe jo vetëm. • Të kenë aftësi të zgjidhin probleme që kanë lidhje me kërkimin, zhvillimin apo inovacionin për të mbështetur operacionet e reja të biznesit, si edhe për të fituar pjesë të tregut. • Të jenë kompetentë të kryejnë transformime thelbësore në pozicionet e punës ku punojnë, tju japin drejtim situatave të paparashikueshme duke gjetur zgjidhje strategjike për subjektet ku aktualisht kryejnë praktikën profesionale apo janë të punësuar. <p><i>GVJ gjykon se duke qene se ky program është Master profesional, lëndët në përmbajtje të tyre dhe të shprehura edhe në planin mësimor të kenë detyra kursi apo projekte në varësi të lëndëve. Kjo gjë shprehet në syllabuset e lëndëve si detyrime dhe vlerësime për lëndën por jo në planin mësimor me kredite përkatëse. GVJ gjykon se kjo mënyrë riorganizimi i planit mësimor do ta bënte më praktik programin e studimit dhe do të ndihmontë në përmushjen e objektivave të programit të studimit.</i></p>




	<p>Gjithashtu GVJ, në shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni por edhe gjatë vizitës në institucion nuk evidentoi ndonjë model të njëjtë apo të ngjashëm që ky program studimi i është referuar për hapjen e tij.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullore e programit të studimit Master Profesional Administrim Biznesi 60 kredite</i></p>			
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Referuar dokumentit (<i>Aneks 14.1.</i>), raporti leksion/seminar mundëson përforcimin e njohurive teorike dhe aplikimin e tyre nga studentët. Gjithashtu referuar syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me studentë dhe stafin akademik të programit, GVJ konstatoi se studentët përfshihen në detyra, raste studimore me fokusin e lidhjes së teorisë me praktikën, duke i shërbyer mobilitetit dhe punësimit më të mirë të studimeve në sajë të aftësive praktike më të mira në përfundim të studimeve.</p> <p><i>Aneks 14.1 Plani mesimor Master Profesional AB 19-20</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se programet e të gjitha lëndëve përditësohen në fillim të çdo viti akademik nga titullari apo pedagogu i lëndës. GVJ, bazuar tek syllabuset e lëndëve, evidentoi se literature e detyruar dhe ndihmëse janë botime të 5 viteve të fundit.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendëve Master profesional 60 ects.</i></p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ është e mendimit që përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave në fushën e kontabilitetit, financës dhe menaxhimit.</p> <p><i>Aneks 14.1 Plani mesimor Master Profesional AB 19-20</i></p>			
<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Organizimi i lendeve në programin e studimit, duke u mbështetur në detyrat individuale, rastet studimore si dhe diskutimeve, i shërben potencialisht sigurimit të aftësive, kompetencave dhe formimit të thelluar profesional, por natyrisht numri shumë i vogël i studentëve është një sfidë për stafin akademik dhe për studentët e programit, sepse nuk krijon mundësi për detyra komplekse, detyra grupi etj.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendëve Master profesional 60 ects</i></p>			
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ sic është shprehur edhe më sipër, rekomandon që: <i>programi i studimit në mënyrë që të mundësojë punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, nëpërmjet kompetencave të fituara, të përshtatet në vazhdimësi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi II.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar dokumentave të DVV dhe dokumentave shitesë që u kërkuan gjatë vizitës, GVJ konstatoi se stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020 është: 25 staf akademik, 14 PAE nga të cilët 1 me gradën Prof. Dr; 3 me gradën Prof. Asoc; 3 me gradën Dr, 7 me Msc, dhe 11 PAK, nga ku 2 me Dr dhe 9 me Msc.</p> <p>Përsa më sipër, personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohet në këtë program studimi nuk përmbush kërkesat ligjore në fuqi, më konkretisht pikës 6 të nenit 59 të ligjit 80/2015, ku thuhet se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të këtë të paktën kualifikimin e ciklit pasardhës.</p> <p>Duke u bazuar në dokumentacion (Aneksi 25), rezulton se numri total i orëve mësimore të kryera nga stafi akademik PAE dhe PAK për këtë program studimi, është 855 orë mësimore, nga të cilat 510 orë ose 60% mbulohet nga staf akademik PAE dhe 345 orë mësimore ose 40 % mbulohet nga staf akademik PAK. Mosplotësim i kriterit ligjor të përcaktuar në VKM 418, pika 2 shkronja b.II, ku thuhet se personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70 % të ngarkesës së programit, justifikohet nga marrëveshja që TBU ka nënshkruar me MASR “Për përcaktimin e personelit akademik me kohë të plotë në njësitë bazë”.</p> <p>Të dhënat për orët mësimore në këtë dokumentacion (Aneksi 25) për këtë program studimi janë më shumë se dyfishi i orëve mësimore të deklaruara në planin mësimor (Tabela 10, Aneksi_Tabelat permbledhese per Aneks_RVB (1)) për këtë program studimi.</p> <p>GVJ konstaton se ka paqartësi dhe parregullsi në orët mësimore të deklaruara që mbulohen nga stafi akademik.</p> <p>Referuar CV (Aneksi 20) të stafit akademik me kohë të plotë apo të pjesëshme, GVJ është e mendimit se një pjesë e stafit akademik të përfshirë në këtë program, nuk ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik, titull akademik dhe/ose gradë shkencore. Referuar CV-ve të stafit, rezulton se fusha akademike kërkimore shkencore e përgjithshme dhe specifike janë në përputhje me natyrën e lëndëve që ata mbulojnë.</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p><i>Aneksi 25_ Te dhena tabelore ngarkesa e plote stafi akademik.</i> <i>Aneksi_Tabelat permbledhese per Aneks_RVB (1).</i> <i>Aneksi 20_CV_Stafi Akademik Programi MP_AB 60 ECTS.</i> <i>Aneksi shtese 06_Mareveshja MASR_TBU_percaktimi_personaleti_akademik.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në RVB si edhe gjatë takimit që GVJ pati me drejtuesit e institucionit sikurse edhe me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, u evidentua se në nivel institucional ka shumë marrëveshje bashkëpunimi kryesisht me kompani private në vend të cilat sigurojnë edhe zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p><i>Aneks 32. Tabele permbledhëse Institucionet bashkepunuese.</i> <i>Aneks 34. TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme.</i> <i>Aneks 35. Raporti periodik perfitim marreveshje bashkepunimi.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Ky program studimi nuk kryen laboratore dhe për këtë arsye nuk nevojitet e nuk ka personel ndihmës për laboratorët. GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, RVB si edhe gjatë vizitës në institucion, konstatoi se institucioni është i angazhuar për funksionimin e bibliotekës. Bazuar në dokumentacion (Aneksi 22), në programin Master profesional “Administrim Biznesi”, me profile, nuk ka të angazhuar staf ndihmës akademik.</p> <p><i>Aneksi 22 CV Stafi ndihmes akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Bazuar në RVB si edhe gjatë takimit që GVJ pati me drejtuesit e institucionit sikurse edhe me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profilin Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, u evidentua se në nivel institucional ka shumë marrëveshje bashkëpunimi kryesisht me kompani private në vend të cilat sigurojnë edhe zhvillimin e praktikës profesionale.</p> <p><i>Megjithatë, GVJ nuk evidentoi dhe nuk ka asnjë dokumnet për sa i përket sugjerimeve apo propozimeve nga bashkëpunëtorët dhe partnerët në tregun e punës në lidhje me përmirësimin apo ndryshimin e programit të studimit.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>Aneks 32. Tabele permbledhëse Institucionet bashkepunuese.</i> <i>Aneks 34. TBU - Marreveshje bashkepunimi me institucione te ndryshme.</i> <i>Aneks 35. Raporti periodik perfitimi marreveshje bashkepunimi.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>TBU, nëpërmjet pyetësorëve të studentëve, synon të sigurojë informacion për efektivitetin dhe mbarëvajtjen e studimeve të tyre. Referuar takimit me studentët, me stafin akademik si dhe me drejtuesit, këto pyetësorë drejtohen për stafin akademik të përfshirë në programin e studimit.</p> <p><i>GVJ është e mendimit që pyetësori për studentët të përmbajë edhe një seksion pyetjesh për përmirësimin e programit të studimit në mënyrë të drejtpërdrejtë.</i></p> <p><i>Gjithashtu sugjerohen përfshirje edhe të metodave të tjera alternative me proaktive për të siguruar perceptimin e studentit në lidhje me programin e studimit, si organizimin e fokus grupeve apo tryezave të rrumbullakta me pjesëmarrjen e studentëve.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Pranë TBU, është krijuar rrjeti Alumni, i cili mban kontakte të vazhdueshme me ish-studentët e programit dhe të fakultetit, për të siguruar prej tyre informacion në lidhje me punësimin por edhe përmirësimin e programit të studimit. Gjatë takimit që GVJ pati me drejtuesit e institucionit si edhe me studentët e programit të studimit, ju komunikua se studentët e diplomuar ftohen vazhdimisht të marrin pjesë në seminarët apo në leksionet e hapura të ofruara nga stafi akademik i TBU apo lektorë të ftuar.</p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>Në RVB (Aneksi 35) paraqitet në mënyrë të përmbledhur përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit e cila konsiston në praktikat profesionale, intership si edhe në punësimin e studentëve apo të diplomuarve në këtë program studimi.</p> <p>Gjithashtu institucioni ka disa marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione të arsimit të lartë publike dhe private. Në bashkëpunim me ta, institucioni herë pas here organizon trajnime dhe leksione të hapura duke ftuar staf akademik dhe ekspertë të fushave të ndryshme prej këtyre institucioneve.</p> <p><i>Aneks 35. Raporti periodik përfitimi marrëveshje bashkëpunimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi III.1				
Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit (Aneksi 39) në sistemin AMS të ASCAL, nga takimet me drejtues të njëjve kryesore dhe bazë, rezultoi se TBU trajnon dhe udhëzon stafin për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit. TBU zhvillon trajnime të ndryshme të vazhdueshme lidhur me përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies duke nxitur përdorimin e metodave të reja sipas specifikave të fushës përkatëse.</p> <p><i>Aneksi 39. Udhëzim për zhvillimin përdorimin metoda innovative mesimdhënies.</i></p>			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>GVJ konstatoi se njësi bazë dhe NJSBC, zhvillojnë mekanizma monitorimi me qëllim vlerësimin periodik dhe të vazhdueshëm të aftësive mësimdhënëse, duke përcaktuar edhe objektivat për të ardhmen. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në pyetësorët e studentëve që organizohen dy here në vit, në fund të çdo semestri. Vlerësimi bëhet për lëndën si edhe për performancën e pedagogut. Gjithashtu TBU organizon edhe pyetësorë për stafin akademik në lidhje me mësimdhënien, studentët, etj.</p> <p><i>Aneksi 40. Pyetësori i studenteve</i> <i>Aneksi 41. Pyetësori i stafit akademik</i></p>			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	<p>Nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezultoi se studentët para përfundimit të çdo semestri përfshihen në sondazhet për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Drejtuesit e njëjve kryesore dhe asaj bazë janë të angazhuar për trajtimin e ankimimeve, nëpërmjet procedurave të cilat janë të sanksionuara dhe në rregulloren e TBU.</p>			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>NJSBC si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në TBU, realizon sondazhet e studentëve dhe harton raportin vjetor me gjetjet e këtij studimi i cili i komunikohet drejtuesve të institucionit. Rezultatet e pyetësorit diskutohen në departament.</p> <p><i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i></p>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>NJSBC si njësi përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në TBU, realizon sondazhet e studentëve dhe harton raportin vjetor me gjetjet e këtij studimi i cili i komunikohet drejtuesve të institucionit. Rezultatet e pyetësorit diskutohen në departament me stafin akademik, e me fokus në shkëmbimin e përvojës në organizimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështetur në praktikat më të mira, si edhe përmirësimin e mësimdhënies dhe elementëve të tjerë didaktikë dhe të komunikimit.</p> <p><i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




				X
--	--	--	--	----------

Standardi III.2	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>Referuar rregullores së programit, syllabuseve të lëndëve si dhe takimeve me stafin akademik dhe studentët, GVJ konstaton se në këtë program studimi, përdoren forma alternative leksione/seminare/projekte/detyra kursi. Mes specifikimeve që ka rregullorja dhe përcaktimeve të këtyre formave në syllabus, GVJ konstaton se ka përputhshmëri.</p> <p>Referuar planit mësimor, rezulton se cdo lëndë e semestrit të parë dhe të dytë zhvillohet në ngarkesën 2 leksione dhe 2 seminare/javë dhe 6 kredite. Për cdo lëndë të semestrit të parë realizohen 60 orë në auditor dhe 90 orë studim individual jashtë auditorit. Këto forma leksione, /seminare dhe praktikë mësimore janë të miratura nga institucioni në planin mësimor.</p> <p><i>Aneksi 14.1 Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i></p>
Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	<p>Referuar takimeve me studentë dhe stafin akademik të programit rezulton se, stafi akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke përshtatur dhe ofruar mundësi dhe forma alternative të mësimdhënies, të kontrollit të dijes dhe duke qenë proaktiv për të përmirësuar mësimdhënien e tij. Kështu u konstatua nga takimi me studentët se përveç leksioneve, gjatë seminareve përpos kontrollit të njohurive nëpërmjet pyetjeve/përgjigjeve, diskutimeve, aplikohen edhe: a) rastet studimore, b) detyrat individuale, c) analizat krahasuese mes praktikave më të mira në kontekstin e bizneseve shqiptare.</p> <p>Gjithashtu gjatë takimit që GVJ pati me drejtuesin e departamentit si edhe me stafin akademik, u konstatua se për këtë program studimi është aplikuar edhe mësimi i individualizuar për shkaqe personale dhe familjare të studentëve.</p>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	<p>Nga vizita në institucion rezulton se TBU, me synimin e përmirësimit të kompetencave didaktike, të metodologjive të mësimdhënies, ka zhvilluar leksione të hapura apo trajnime edhe për stafin akademik. Partneriteti në projektet Erasmus i ka krijuar mundësi stafit akademik të këtij programi për tu angazhuar në universitetet e tjera partnere në trajnime dhe mësimdhënie në to. (Aneksi shtesë 02, 03, 04). Kjo ka ndihmuar stafin akademik në përmirësim dhe në shtimin e eksperiencës në fushën dhe metodat e mësimdhënies.</p> <p>GVJ, referuar CV (Aneks 19), fushave të ekspertizës, eksperiencës së stafit, takimeve me studentët dhe perceptimeve të tyre, është i mendimit se, stafi akademik i programit zotëron kompetencat e duhura të mësimdhënies. Një pjesë e stafit është me tituj dhe grada shkencore sikurse edhe me eksperiencë dhe ekspertizë në fushat përkatëse të lëndëve ku ata janë të përfshirë në mësimdhënie. Institucioni ka në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>qëndër të vëmendjes përfshirjen e studentëve në përmirësimin e cilësisë së personelit akademik dhe të metodave të mësimdhënies. TBU nëpërmjet anketave të studentëve, paraqitjes dhe shqyrtimit të ankesave dhe opinioneve të studentëve, synon vlerësimin dhe vendos objektivat për përmirësimin e metodave didaktike.</p> <p>Informacioni i siguruar nga studentët, gjatë vizitës në institucion dëshmon se stafi akademik përdor metoda të ndryshme interaktive për të ndërthurur teorinë me praktikën, por edhe për të rritur atraktivitetin e orëve të mësimin.</p> <p>Numri i vogël i studentëve, në kete program studimi rrit mundësinë e fleksibilitetit në përdorimin e metodave alternative, por nga ana tjetër krijon mundësinë për më tepër detyra individuale sesa grupi, duke inkurajuar autonominë e tyre, por duke pasur në fokus respektimin e rregullores si dhe të përcaktimeve në syllabus.</p>			
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.				
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.				
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.				
Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	<p><i>Aneksi shtese 02_ IIA_TBU_Staffordshire_University_2017.</i> <i>Aneksi shtese 03_ IIA_TBU_Staffordshire_University_2018.</i> <i>Aneksi shtese 04_TBU_Inter-Institutional Agreement_Bielefeld.</i> <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional 60 ects.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Nga vizita në institucion u konstatua që e gjithë infrastruktura e cila ishte në funksion të procesit mësimor dhe plotësonte të gjitha standardet. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve, janë të mjaftueshme, duke pasur parasysh edhe numrin e vogël të studentëve. Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se godina permban salla për leksione, për seminare dhe bibliotekë. Këto ambiente rezultojnë të jenë në standardet e duhura të mirëmbajtjes dhe kushteve higjieno-sanitare.</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion, rezulton se sallat në dispozicion të procesit mësimor, disponojnë infrastrukturë dhe logjistikë të pranueshme dhe të nevojshme, poste ulje, tavolina, pod lekturimi, ëhite board, videoprojektor.</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Referuar RVB, dhe informacionit të siguruar gjatë vizitës në institucion, TBU përdor intranetin si një mënyrë për komunikimin e brendshëm sikurse edhe faqen ëeb për komunikim për një audiencë më të gjerë. I gjitha stafi akademik efektiv në zyrën e tij, por edhe stafi me kohë të pjesshme në postet e përcaktuara për ta, janë të pajisur me kompjuter dhe të gjitha mjetet e nevojshme për mbarëvajtjen e punes. Salla e bibliotekës gjithashtu është e pajisur edhe me kompjutera ku studentët mund të punojnë për detyrat e kursit apo për projektet etj.</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga takimet me stafin akademik, drejtues të njësisë kryesore dhe atë bazë si dhe referuar syllabuseve të lëndëve, konstaton se të gjitha lëndët, kanë literaturën e 5 viteve të fundit. Ndërkohë referuar vizitës në bibliotekën e institucionit, konstatohet se numri i librave (fizike) është i vogël sidomos në literaturë ndihmëse, ndërkohë që konstatohen edhe burime alternative si biblioteka dixhitale EBSCO. Biblioteka dixhitale EBSCO është në funksion të studentëve dhe stafit akademik për të përdorur literaturë ndihmëse apo artikuj shkencorë që gjenden në të.</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Për sa më sipër, GVJ është e mendimit, <i>se institucioni duhet të ndërmarrë iniciativa për shtimin e titujve për literaturën bazë dhe ndihmëse, periodikëve, revistave në hard copy.</i></p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Referuar planit mësimor, (RVB, tabela 10. 2), ky program studimi nuk kryen laboratorë dhe sallat e laboratorëve janë të panevojshme. <i>Por GVJ sygjeron, që në lëndë të vecanta psh në lëndët e kontabilitetit të përdoren laboratorët për aplikimin e softëare në fushën e kontabilitetit për mbajtjen e llogarive.</i> <i>Kjo do ta ndihmonte studentin për aplikimin e njohurive teorike në praktikë.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	Salla e bibliotekës është e pajisur edhe me kompjutera ku studentët mund të punojnë për detyrat e kursit apo për projektet etj. <i>Aneksi_Tabelat permbledhese per Aneks_RVB (1)/ tabela 10.2</i>			
Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Gjatë vizitës në institucion GJV evidentoi përdorimin e një sistemi online interaktiv në TBU që i shërben studentëve të komunikojnë me stafin, të lexojnë materiale mësimore, të marrin informacion lidhur me eventet e TBU apo njoftime të ndryshme, etj. Nëpërmjet këtij sistemi, stafi akademik mund të depozitojë materiale ndihmëse si edhe mund të komunikojë me studentët dhe strukturat e tjera të TBU. Ky sistem u përdor totalisht gjatë periudhës së pandemisë Covid 2019.			
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	TBU merr masa për pajisjen me email të studentëve/stafit dhe ofron këshillimin e nevojshëm për përdorimin e emailit. Nga informacioni i siguruar nga sekretaria e institucionit, studentët e programit dhe stafi akademik kanë mundësinë që nëpërmjet kredencialeve personale të aksesojnë dokumentacionin elektronik. Gjithashtu në Google classroom pedagogët mund të vendosin materialet në lidhje me tematikat përkatëse etj.			
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Nga informacioni i siguruar gjatë takimit me stafin akademik, studentët Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës, informon studentët, për fushat e studimit dhe tematikat orientuese për tezat e diplomës, kjo nëse studentët përmbushin detyrimet për të punuar temë diplome dhe jo provim formues. Studenti gjithashtu ka lirinë të propozojë vetë një temë diplome së bashku me udhëheqesin përkatës. Duke qenë se numri i studentëve është i vogël, krijon mundësinë për të respektuar zgjedhjet e tyre dhe për t'i udhëhequr ata drejt realizimit të punimeve cilësore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4 Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	TBU ka ngritur strukturën e NJSBC, e cila ka funksion kryesor sigurimin e cilësisë së brendshme. Kjo njësi është në nivel institucional, realizon pyetësorët e studentëve, perpunimin dhe analizën e tyre, si dhe harton raportin në nivel institucional. GVJ konsultoi raportin vjetor për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor i cili konsiderohet një formë që i shërben plotësimi të këtij kriteri, por GVJ është e mendimit se: <i>NJSBC duhet të hartojë, në mënyrë të posaçme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vet, mekanizmat e përdorur dhe identifikimin e praktikave të mira /problematikave dhe të propozojë/adresojë zgjidhje për to.</i> <i>GVJ është e mendimit se institucioni duhet të përmirësojë ndjeshëm dokumentimin e vazhduar të proceseve të realizuara për përmirësimin e</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>cilësisë.</i></p> <p><i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Përcaktuar edhe nga ligji i arsimit të lartë, Departamenti që ofron programin e studimit është përgjegjës për gjithë cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të të nxëniet që ai ofron. Njësia bazë mbështet dhe nxit proceset, të cilat synojnë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e cilësisë së programit të studimit.</p> <p>GVJ konstaton se njësia bazë inicion procese për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet trajnimeve të ndryshme. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohen trajnime të realizuara, mbështetur në burime të brendshme/ të jashtme për implementimin e metodave të reja.</p> <p>Zhvillimi i trajnimeve për metodat e mësimdhënies, është tregues i nxitjes së njësisë bazë për përdorimin e metodave të reja. Njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik. Nga takimi me GVB, me përgjegjës të departamentit, rezulton se njësia bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe jep informacion të detajuar për cilësinë e programit të studimit dhe përmbajtjen e tij ndaj studenteve. Secili pedagog i programit të studimit në fillim të semestrit rishikon syllabus-in e lëndës, i cili më pas shqyrtohet nga përgjegjësi i departamentit për zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p> <p>Kualifikimi në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për përmirësimin e mësimdhënies në këtë program studimi është nën mbikqyrjen e Departamentit të Kontabilitetit dhe Financës si edhe në nivel Fakulteti. Nga takimet me stafin akademik u vu re një prirje e vazhdueshme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies si dhe për përputhjen e tij me objektivat e programit të studimit. I gjithë stafi, dhe vecanërisht ai i ri, trajnohet me mënyrën e funksionimit të cilësisë. Mobiliteti i stafit akademik realizohet në kuadër të: projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si projekti Erasmus +.</p> <p>GVJ bazuar në CV e stafit akademik të programit (Aneksi 20) evidenton se stafi akademik merr pjesë me referime në konferenca shkencore dhe botime në revista shkencore.</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<i>Aneksi 20. CV_Stafi Akademik Programi MP_AB 60 ECTS.</i>			
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	GVJ gjatë vizitës në institucion konstaton se personeli ndihmës akademik, është i angazhuar për të kryer detyrat, angazhimi i pedagogëve nga departamentet e tjera të Fakultetit të Administrim Biznesit dhe bashkëpunimi në vazhdimësi për të siguruar nevojat e programit të studimit është një element pozitiv për këtë program studimi.			
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	Një nga synimet që TBU ka është implementimi i inovacionit edhe në fushën e mësimdhënies. Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik u theksua se prej tyre synohej një mësimdhënie dhe komunikim interaktiv duke shmangur në maksimum mësimin tradicional ku lektorët janë folës dhe studentët dëgjues. Sipas tyre, kjo mënyrë e mësimdhënies ishte më efektive sepse shmangte monotoninë dhe rriste vëmëndjen dhe përfshirjen e studentit në orën e mësimi.			
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se TBU, angazhon lektorë në procesin mësimor, si lektorë të ftuar apo kërkues shkencorë jashtë institucionit për shkëmbim të ideve dhe eksperiencave.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Gjatë takimit që GVJ pati me stafin akademik por edhe drejtuesin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, si edhe në syllabuset e lëndëve dhe në takimin me studentët, konstatoi se mënyra e vlerësimit bëhet e qartë që në fillimin e semestrit, në prezantimin e lëndës dhe të gjithë elementëve të syllabusit.
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Referuar dokumentit (Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU), rezulton se janë të parashikuara dhe të përcaktuara mënyrat e vlerësimit të studentëve si dhe për detyrimin e studentëve për nivelin e frekuentimit të programit. Kontrolli i dijes për studentët, realizohet nëpërmjet vlerësimit semestral. Skema e vlerësimit për çdo komponent të kontrollit të dijes përcaktohet në syllabus. Kështu në shumicën e lëndëve elementët e skemës së vlerësimit janë: - Pjesëmarrja në leksione dhe aktivizimi në seminare
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




njohurive, dijeve dhe aftësi profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<ul style="list-style-type: none"> - Kontrolli i ndërmjetëm - Detyra e kursit - Provimi përfundimtar <p>Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezulton se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit, masa e vlerësimit të çdo komponenti. Këto forma janë alternative dhe të diversifikuara duke iu dhënë mundësi të gjithë studentëve, të demonstrojnë njohuritë e përfituara.</p> <p>Gjithashtu referuar edhe syllabuseve që institucioni ka dorëzuar, konstatohet se pedagogët që mbulojnë disiplinat e këtij programi kanë të pasqyruara qartë në syllabuse dhe zbatojnë formate të qarta të procesit të vlerësimit të vazhduar dhe të vlerësimit përmbledhës</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësi profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Është në politikën e institucionit vlerësimi i përgatitjes akademike në mënyrë të vazhdueshme përgjatë gjithë vitit shkollor. GVJ referuar burimeve alternative, syllabuseve, stafit akademik dhe studentëve, konkludon se vlerësimi është semestral, me komponente të tillë si detyra individuale, detyra kursi, provime të ndërmjetme dhe provimi final. Të gjithë komponentët reflektohen në vlerësimin final. <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional 60 ects.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni nuk aplikon sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësi profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Nga komunikimi me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë, rezulton se testimi përfundimtar realizohet nga një komision, i cili rezulton se ka jo më pak se 2 anëtarë, këto komisione miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Në komision njëri nga anëtarët është titullari i lëndës.
Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	Bazuar në RVB, provimet me shkrim bëhen me sekretim nga sekretaria mësimore duke vendosur ID e studentit.
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësi profesionale shoqërohet me komente/ feedback	Ashtu sikurse edhe theksohet në statutin e institucionit, procedurat e vlerësimit rezultojnë të jenë transparente, ku stafi akademik realizon

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>(nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>vlerësim të arsyetuar të të gjithë komponentëve të parashikuar në detyrimet akademike. Studentët kanë të drejtë të marrin feedback dhe të konsultojnë vlerësimin e tezave të tyre, si mundësi për përmirësimin e rezultatatit të tyre në të ardhmen.</p> <p><i>Aneksi 5_Rregullore e Institucionit_TBU.</i></p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Provimet zhvillohen me mbikëqyrje nga komisioni i provimit. Në dokumentat përkatëse të institucionit, referuar (<i>Aneksi 5. Rregullore e institucionit</i>), janë të parashikuara rregullat e provimit por jo se çfarë ndodh me studentin në rast kopjimi.</p> <p><i>GVJ bazuar në rregulloren e institucionit, në rregulloren e programit të studimit por edhe RVB, evidenton se mungon parashikimi se çfarë do të ndodhë me studentin nëse evidentohet kopjimi apo edhe plagjatura. Në RVB vetëm theksohet se për të shmangur kopjimin provimet kombinohen të organizuara me shkrim dhe me goje.</i></p> <p><i>Për evidentimin dhe kontrollin e plagjaturës GVJ nuk evidentoi ndonjë informacion nëse institucioni disponon një program për kontrollin e saj.</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Nga takimi me studentët e këtij program studimi, rezultojnë, se vlerësimet i marrin në kohën e përcaktuar sipas rregullores. Në seancën e fundit mësimore studentët informohen për vlerësimet gjatë semestrit. Këto vlerësime janë komponentë të vlerësimit final. Studentët brenda 10 ditëve nga kryerja e provimit marrin nëpërmjet emailit të tyre personal, nga sekretaria mësimore, notën e tyre të provimit.</p> <p>Nga ky takim për GVJ, rezultojnë se perceptimi i tyre është për vlerësim mbi bazë të meritës.</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të depozituar nga TBU (<i>Aneksi 5</i>) por edhe takimeve me studentët e programit, studenti ka të sanksionuar të drejtën për tu njohur me vlerësimin, me menyrën e korrigjimit, për të qenë i qartë për gabimet/mungesat në përgjigje dhe për vlerësimin sipas meritës. Në rast se studenti edhe pas marrjes së rezultateve nuk është i bindur për saktësinë e vlerësimit atëherë ai ka të drejtë që brenda afateve të parashikuara në rregullore të paraqesë një kërkesë me shkrim për rishikim të vlerësimit të provimit.</p> <p><i>GVJ referuar (Aneksi 5, neni 22. Rregullore e institucionit), konstaton se është parashikuar ankimimi i provimeve. Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të provimit dhe vlerësimit. Studentët kanë të drejtë e ankimimit të rezultatatit të provimit brenda një afati prej 3 ditor nga dhënia e njoftimit dhe ankimimi i njoftohet menjëherë pedagogut të lëndës. Shqyrtimi i ankimimit kryhet nga pedagogu i lëndës brenda 7 ditësh nga marrja e njoftimit nga sekretaria. Vendimi i tij për notën është përfundimtar. Nëse rasti lidhet me çështje të etikës, kjo trajtohet sipas kodit të etikës por pa efekte në notën e dhënë nga pedagogu.</i></p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni (<i>Aneksi 5</i>) dhe gjatë vizitës në institucion nuk arriti të evidentojë nëse procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë regjistrohen në regjistrin e ankesave të studentëve që mbahen në dekanat.</p> <p><i>GVJ sugjeron mbajtjen dhe dokumentimin e procedurave të tilla.</i></p> <p><i>Aneksi 5_Rregullore e Institucionit_TBU.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p> <p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Referuar informacionit të siguruar nga takimet me studentët dhe stafin akademik, rezultojnë se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve; në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet rasteve studimore, detyrave të grupit, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve.</p> <p>Programi i studimit përmban lëndë të tilla të cilat ndihmojnë në zhvillimin e aftësive të veçanta të studentëve, në fushën e komunikimit, lidërshiptit etj. Mësimdhënia është në gjuhën shqipe.</p> <p><i>Aneksi 14.1_Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Nga takimi me studentët e programit, në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës dhe rezultatet e pritshme. Nëpërmjet pyetësorëve të realizuar në fund të semestrit, sigurohet informacion i përgjithshëm për cilësinë e aftësive që ata fitojnë.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Referuar informacionit të siguruar nga studentët e programit si dhe nga pedagogët, çdo pedagog realizon një përmbledhje të lëndës, temave kryesore dhe orienton studentët rreth testit përfundimtar, dhe adreson paqartësitë që studentët kanë. Gjithashtu, pedagogët janë në dispozicion të studentëve për konsultime nëse do të ishin të nevojshme përpara provimit.</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ referuar shqyrtimit të dokumentacionit (Aneksi 47) dhe vizitës në institucion konstaton, se studentët e programit, kanë marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të zhvilluara, në të cilat ata informohen rreth inovacioneve dhe menaxhimit të biznesit. Këto seminare dhe trajnime, realizohen jashtë strukturës së programit të studimit dhe në orare që nuk bien ndesh me procesin mësimor.</p> <p><i>Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb.</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Referuar programit të studimit dhe syllabuseve si dhe takimeve me stafin dhe studentët e programit, rezultojnë se në procesin e mësimdhënies organizimi i orës së mësimi i përshtatet natyrës së lëndëve dhe synon angazhimin e të gjithë studentëve për një mësimnxënie optimale, zhvillim kompetencash si dhe aplikim i njohurive të siguruar nga teoria.</p> <p><i>Aneksi 14.1_Plani mesimor Master Profesional AB 19-20.</i> <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional 60 ects.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Referuar syllabuseve të lëndeve dhe informacionit në takimet me studentët dhe me stafin e programit, GVJ konstaton se pedagogët inkurajojnë studentët të përfshihen në aktivitete dhe detyra grupi për adresimin e problemeve në të cilat ndeshen bizneset në aspektin manaxherial dhe jo vetëm.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional 60 ect.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>GVJ është i mendimit se gjatë procesit mësimor, personeli akademik mbështet idetë inovative të studentëve në zgjidhjen e problemeve të biznesit lidhur me financën, kontabilitetin dhe menaxhimin.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional 60 ect.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Zhvillimi i njohurive praktike dhe sidomos përkrahja e zhvillimit të iniciativës së lirë dhe sipërmarrjes tek studentët, jo vetëm që përmbush një nga objektivat e TBU, por përbën edhe një kontribut në zhvillimin e shoqërisë. Në këtë kuadër, TBU ka zhvilluar projektin: “Inkubatori i Biznesit Studentor” përmes së cilit mbështeten nisma sipërmarrëse të studentëve të TBU. Inkubatori i biznesit vë në dispozicion të këtyre nismave falas mjedise fizike të shkollës, pajisje, lidhje në internet, këshillim nga stafi akademik ose persona me eksperiencë, mundësi për bashkëpunim me bizneset partnere për të siguruar suportin e tyre financiar dhe teknik.</p> <p>GVJ, për këtë i referohet dokumentacionit të dorëzuar nga institucioni.</p> <p><i>Aneksi 47. Te dhena nga faqja zyrtare ëeb, link 18.</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>GVJ konstaton bashkëpunime mes TBU dhe institucioneve të ndryshme, të cilat synojnë përfshirjen e studentëve në intershipe, për të rritur mundësinë e punësimit të tyre. Nga takimi me stafin akademik, stafi i mentoron studentët në praktikë, për ti orientuar ata të aplikojnë njohuritë teorike të marra në auditor, në mjedise reale biznesi.</p> <p>Në takimin që GVJ pati me studentët, thuajse të gjithë studentët pjesmarrës në takim ishin të punësuar, dhe pjesa më e madhe e tyre të punësuar në profilin e studimeve.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.8 Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për</p>	<p>Nga sa rezultoi nga vizita në institucion si dhe nga takimet me studentët, GVJ konstatoi se, praktikat profesionale zhvillohen në mjedise jashtë fakultetit kryesisht pranë bizneseve me të cilët institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi ose në biznese që studentët janë të punësuar. Ky program studimi nuk realizon praktikë laboratorike, për shkak të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	natyrës së programit të studimit.			
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	GVJ konstatoi se institucioni për praktikat profesionale në program, ka vendosur lidhje bashkëpunimi me një numër institucioneve dhe subjektsh private që plotësojnë kushtet e kërkuara nga natyra e programit të studimit. Subjektet ku realizohen praktikat mësimore (për studentët që janë të papunë, ose të punësuar jashtë profilit të programit të studimit), angazhojnë edhe mentorues që në bashkëpunim me pedagogët dhe procedurat e vlerësimit të praktikave sipas rregullores së programit, të realizojnë qëllimin e tyre. <i>Aneksi 34_TBU - Marreveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme.</i>			
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale ka 6 kredite dhe në përfundim të saj studentët duhet të përgatisin relacionin e praktikës që ka 6 kredite. Kjo praktikë rezulton të dokumentohet dhe studenti para mbrojtjes së saj para komisionit duhet të depozitojë vërtetimin e zhvillimit të praktikës si dhe relacionin e praktikës i cili në planin mësimor është 6 kredite (<i>Aneksi shtese 18_Rregullore për praktikën mësimore</i>). <i>GVJ sygjeron shkrimin e praktikës profesionale me relacionin e praktikës, duke mos qenë 2 veprimtari të ndryshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.	Referuar dokumentacionit, (<i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU.</i>), rezulton se Institucioni ka parashikuar procedurën e diplomimit. Studenti duhet të mbrojë provimin e diplomimit ose punim diplome për studentët me mesatare mbi 7. Për provimin/punimin e diplomës janë parashikuar 6 kredite. Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së provimit/punimit të diplomës studentit duhet të ketë fituar 54 kreditet e nevojshme. Institucioni paraqet nëpërmjet akteve rregullatore në mënyrë të detajuar çdo procedurë që ndiqet që nga faza e parë deri në fazën finale të mbrojtjes së diplomës. Tema e diplomës dhe udhëheqësi miratohen nga përgjegjësit e departamenteve të paktën rreth 4 muaj para përfundimit të pritshëm të studimeve. (<i>Aneksi 5, Neni 27. Rregullore e Institucionit_TBU.</i>). Drejtuesi (udhëheqësi shkencor) i temës së diplomes mund të jetë: çdo pedagog i TBU-së ose ndonjë person tjetër i përcaktuar rast pas rasti dhe i miratuar nga përgjegjësi i departamentit. Drejtuesi i punimit të diplomës i miratuar nga përgjegjësi i departamentit perkates ndihmon studentin në të gjitha fazat e përgatitjes së punimit dhe, në përfundim,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>bën vlerësimin e tij sipas një formulari (<i>Aneksi shtese 01. Udhezim për pergatitjen e temes se diplomes</i>). Pas dorëzimit të punimit në departament në afatet e caktuara dhe të vlerësimit të punimit nga drejtuesi, përgjegjësi i departamentit cakton reçentin e punimit i cili e vlerëson atë me shkrim.</p> <p>GVJ konstaton se, procedura për provimin final dhe mbrojtjen e punimit të diplomës është e qartë dhe e bërë publike.</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Referuar rregullores si dhe takimit me studentët dhe stafin akademik të programit, departamenti bën të njohura për studentët temat ose fushat e studimit për përgatitjen e punimeve të diplomave. Studentët paraqesin kërkesat e tyre në departament për temën e zgjedhur dhe preferencën për udhëheqës. Departamenti i shqyrton ato dhe cakton udhëheqësit nisur nga specialiteti dhe kualifikimi i personelit akademik të tij, duke qenë se janë numër i vogël studentësh, preferencat e tyre përgjithësisht merren parasysh.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit_TBU</i> <i>Aneksi shtese 01. Udhezim për pergatitjen e temes se diplomes.</i> <i>Aneksi shtese 12. Nje model kazusi provim formimi MP- AB.</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit konstaton se pasi miratohet prej rektorit të TBU sezoni për mbrojtjen e diplomave dhe provimit final, Dekani i Fakultetit të Administrim Biznesi, përcakton komisionet për mbrojtjen e diplomave dhe provimit final. Provimi final konsiston në një rast studimi apo në ushtrim kompleks, ku synohet që student të testohet për njohuritë e mara. Komisioni vendos notën përkatëse në një proscverbal I cili firmoset prej anëtarëve të komisionit.</p> <p><i>Aneksi shtese 11. Miratimi dekani komisione diplomimi MAP-AB-2019.</i> <i>Aneksi shtese 12. Nje model kazusi provim formimi MP- AB</i> <i>Aneksi shtese 13. Model flete vleresues diplomim me teme.</i> <i>Aneksi shtese 14. Model flete vleresues diplomim provim formimi.</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacion por edhe në takimin që në pati me studentët e programit të studimit si edhe të diplomuar në këtë program studimi konstaton se, drejtuesi i punimit të diplomës i miratuar nga përgjegjësi i departamentit perkates ndihmon studentin në të gjitha fazat e përgatitjes së punimit dhe, në përfundim, bën vlerësimin e tij sipas një formulari</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit</p>	<p><i>Aneksi shtese 01. Udhezim për pergatitjen e temes se diplomes.</i></p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Takimet dhe konsultimet e studentit me udhëheqësin e diplomës janë të vazhdueshme. I gjithë procesi i punimit të diplomës, që nga zgjedhja e temës dhe pedagogut udhëheqës e deri në përfundim të punimit të diplomës, është e qartë në udhëzuesin për përgatitjen e temës së diplomës që u vihet në dispozicion edhe studentëve. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, në përfundim të punimit të diplomës, udhëheqësi jep vlerësimin e tij për punimin e studentit në bazë të një formati të përvaktuar më parë.</p> <p><i>Aneksi shtese 01. Udhezim për pergatitjen e temes se diplomes.</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se në përfundim të provimit apo mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. Komisioni vendos notën përkatëse në një proscverbal i cili firmoset prej anëtarëve të komisionit.</p> <p><i>Aneksi shtese 13. Model flete vleresues diplomim me teme.</i> <i>Aneksi shtese 14. Model flete vleresues diplomim provim formimi.</i></p>			
<p>Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Ashtu sic është e parashikuar në nenin 30 të rregullores së TBU-së, studenti në përfundim të programit ka të drejtë të pajiset me diplomën, dhe suplementin e saj. Forma e diplomës dhe procedurat për regjistrim janë të përcaktuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, për këtë program studimi, konkretisht diploma është e miratuar me Urdhër Nr.32, datë 25.03.2019 të QSHA.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i> <i>Aneksi 15.1. Modeli i diplomes dhe Urdheri i aprovimit MP_AB_60.</i> <i>Aneksi 15.2. Modeli suplementi diplomes MP_AB_60.</i></p>			
<p>Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Bazuar në RVB, GVJ evidenton se studenti më kërkesë të tij, ka të drejtën të pajiset me dokumentacionin e plotë rreth programit të studimit, si plan mësimor, syllabuse, vertetim notash etj.</p> <p><i>TBU RVB Programi Master Profesional AB_60 (perditesuar).</i></p>			
<p>Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>GVJ referuar RVB si edhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me rregulloren e sekretarisë, evidenton se dorëzimi i diplomës dhe i listës së notave i bëhet personalisht vetëm studentit. Pranohet dorëzimi te një person i tretë vetëm në rast se është i pajisur me prokurë të posaçme përfaqësimi i lejuar për të kryer këtë veprim. Çdo dorëzim evidentohet në një dokument të veçantë, ku studenti ose personi përfaqësues nënshkruan emër, mbiemër, firmë dhe numër personal i kartës së identitetit. Temat e diplomes se studenteve te diplomuar ne Bachelor dhe Master Profesional ruhen ne kopje elektronike nga TBU per qellime referimi nga studentet pasardhes, ndersa kopjet e printuara i rikthehen studentit ne momentin qe ai terheq diplomen dhe suplementin e diplomes.</p> <p>GVJ, bazuar në dokumentacion evidenton se Regjistri i lëshimit të diplomave dhe çertifikatave depozitohet në arkivat e shtetit, ndërsa kopja e njësuar me origjinalin ruhet në arkivin e institucionit të arsimit të lartë. Ai plotësohet edhe në formë elektronike. Regjistri i veçantë i diplomimit mbahet në ruajtje të përhershme.</p> <p><i>TBU RVB Programi Master Profesional AB_60 (perditesuar).</i> <i>Aneksi 9. Rregullore për sekretarinë mësimore.</i> <i>Aneksi shtese 19. Regullore per arkivin.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>GVJ konstatoi se TBU, në lidhje me këtë program studimi, disponon të dhënat për çdo semestër, për cdo vit akademik, të stafit akademik që përfshihet në program. Në këto të dhëna përcaktohen edhe lëndët që mbulon secili anëtar i stafit akademik si dhe statusin e tij.</p> <p>Nga konsultimi i dosjeve të stafit të programit, GVJ evidenton se në dosjet e përzgjedhura në mënyrë rastësore gjendet dokumentacioni si, librezë pune, kontrat e punës, diploma dhe lista e notave të noterizuara të studimeve universitare, masterit, doktorata, CV, etj</p> <p><i>Aneksi 20_CV_Stafi Akademik Programi MP_AB 60 ECTS.</i> <i>Aneksi 23_Te dhena Tabelore pers.akad. njesia kryesore_njesia pergjegjese.</i> <i>Aneksi 24_Te dhena tabelore personeli akademik i programit.</i></p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ evidentoi se TBU ka rregullore për përcaktimin e rregullave bazë për punësimin, vlerësimin dhe largimin nga puna të personelit akademik dhe ndihmë-sakademik të njësisve bazë, si dhe personelit administrativ në TBU.</p> <p>Kjo rregullore mbështetet në Ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë si dhe në Statutin dhe Rregulloren e Përgjithshme të TBU.</p> <p><i>Aneksi 11_Rregullore e punesimit.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Në vizitën që GVJ pati në institucion, stafi i burimeve njerëzore shprehet se vendet vakante për personel akademik apo administrativ bëhen publike në faqen ëeb të institucionit (<i>Aneksi 47</i>). Sipas tyre, ndër kandidatët për personel akademik efektiv apo të ftuar, përzgjidhen më të mirët, duke synuar jo thjesht formimin akademik por mbi të gjitha profesionalizmin, ekspertizën dhe eksperiencën në fushat përkatëse ku ata edhe do të angazhohen në mësimdhënie.</p> <p><i>Aneksi 47_Te dhena nga faqja zyrtare ëeb/link 13 Punësimi në TBU</i></p>
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën,</p>	<p>GVJ, konstaton se TBU ka një procedurë në të cilën identifikohen, kriteret e përgjithshme dhe specifike për rekrutimin e personelit, sipas ligjeve në fuqi por GVJ nuk mundi të verifikonte sesi këto procedura aplikoheshin, kush aplikonte, si bëhej vlerësimi i tyre dhe si përzgjidhej apo nëse bëheshin publike këto procedura, GVJ nuk konstatoi mekanizma të bërjes publike të këtyre kriterëve.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëçente dhe efektive	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	Referuar dokumentacionit (Aneks 42), vizitës në institucion, takimeve me stafin akademik dhe administrativ, GVJ konstaton se TBU angazhohet për krijimin e mjedisit të përshtatshëm për personelin. Kështu në godinën e institucionit, ka zyra për personelin akademik me kohë të plotë, një ambjent për personelin akademik të ftuar sikurse edhe zyra për personelin administrativ. <i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB.</i>
Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ nuk evidenton ndonjë mbështetje financiare ndaj stafit akademik dhe administrative për kualifikim të mëtejshëm, në lidhje me metodat inovative, pjesëmarrjen në konferencat të cilat organizohen, duke ndjekur politikën e pjesëmarrjes pa pagesë për ta. <i>Ndërkohë GVJ sugjeron politika më proaktive mbështetje, vendosjen e sistemeve motivuese e stimuluuese të pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare prestigjioze apo botimet në revista shkencore prestigjioze të fushës së ekonomisë.</i>
Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	Nga takimet me stafin akademik, rezulton se TBU, organizon trajnime/ ose leksione të hapura për metodat inovative të mësimdhënies, por gjithsesi GVJ nuk evidentoi ndonje evidencë për të dokumentuar këtë, as në RVB dhe as në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni. Në anekse të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, konkretisht në Aneksin 46. <i>Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit</i> nuk gjendet konkretisht ndonjë udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit, por një material i përkthyer në lidhje me mësimdhënien dhe mësimnxënien me titullin <i>Për Zhvillimin dhe Përdorimin e Metodave të Ndryshme dhe Inovative të Mësimdhënies Tirana Business University College</i> . <i>GVJ rekomandon rritjen e mundesimit të kualifikimit të mëtejshëm për metodat inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja.</i> <i>Aneksi 46. Udhëzues për përdorimin e teknologjisë së informacionit.</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim	Nga i gjithë dokumentacioni i DVV është evidente që institucioni dëshmon një angazhim të plotë të burimeve njerëzore, për përmbushjen

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	e objektivave të programit të studimit. <i>Aneksi 24. Te dhena tabelore personeli akademik i programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	TBU siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme e pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë. Referuar RVB, vizitës në institucion dhe të dhënave për infrastrukturën, GVJ konstaton se institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e mësimin të programit të studimit. Në dokumentacionin (Aneks shtesë 15) e paraqitur nga institucioni evidentohet gjithashtu edhe raporti i MASR për verifikimin e kapaciteteve pritëse për vitin akademik 2019-2020, ku konkludohet se institucioni i përmbushet detyrimet ligjore për kapacitetet pritëse. <i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB</i> <i>Aneksi shtesë 15. Raporti inspektimit të kapaciteteve MASR 19-20.</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ gjatë vizitës në institucion, konstaton se në funksion të cilësisë së mësimdhënies institucioni ka aktualisht 1 laborator IT. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi fizikisht, laboratorin që TBU disponon. Por lëndët nuk kanë laboratore, sipas planit mësimor për këtë program studimi për këtë arsye laboratorët nuk janë të përdorshëm për këtë program studimi. <i>GVJ, sygjeron përdorimin e laboratorëve, në lëndë të vecanta të kontabilitetit dhe financës, duke përdorur softëare në lidhje me to. Duke qenë se është një program studimi master professional, GVJ gjykon se të mësuarit të programeve specifike për mbajtjen e financës dhe kontabilitetit të kompanive, do ta bënte më të vlefshëm dhe më atraktiv këtë program studimi.</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të	Sallat e leksioneve dhe seminareve për këtë program studimi janë të pajisura me kompjuter dhe vidioprojektor, si edhe me tabela për të mundësuar një proces mësimdhënies efektive.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




programit të studimit në tërësi.				
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.		<i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB</i>		
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike		Praktika profesionale zhvillohet pranë bizneseve ku studentët janë të punësuar ose me të cilat TBU ka marreveshje bashkëpunimi. Në fund të praktikës, studenti vlerësohet paraprakisht edhe nga përfaqësuesi i kompanisë ku është zhvilluar praktika sipas aktiviteteve përkatëse. <i>Aneksi shtese 18. Rregullore per praktikën mësimore.</i> <i>Aneksi 32. Tabele perm. institucionet bashkepunuese.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Për realizimin normal të të gjithë procesit mësimor, TBU vë në dispozicion të studentëve, pa pagesë, bibliotekën mësimore, në mënyrë që të sigurojë pjesëmarrje të gjerë të studentëve dhe mundësi të barabartë për të gjithë studentët. Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur (9.00-21.00). <i>Aneksi shtese 16_ Plani per Biblioteken.</i> <i>Aneksi 45 _Database e teksteve Biblioteka.</i>
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Gjatë vizitës në bibliotekën e institucionit, si edhe bazuar në dokumentacion (Aneksi 45), GVJ konstatoi një fond librash fizike, periodike, revista në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj për fushën ekonomisë. Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se në bibliotekë disponohet literatura e mjaftueshme që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore. <i>Aneksi 45. Database e teksteve Biblioteka</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Përveç bibliotekës fizike, TBU disponon edhe bibliotekën online (EBSCO) e cila disponon një mori titujsh që përdoren për literaturë ndihmëse. Studenti ka akses në revista shkencore, libra dhe botime të lidhura me fushën e tij të interesit. Biblioteka pajiset në mënyrë të vazhdueshme me botime periodike si dhe siguron aksese në burime

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë. Këto materiale janë në dispozicion të të gjithë studentëve dhe mund të përdoren në cdo kohë prej tyre. <i>Aneksi shtese 16. Plani per Biblioteken.</i>			
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.	Biblioteka ka vende leximi dhe kompjutera për punime dhe kërkime shkencore dhe është e integruar me laboratorin e IT. <i>Aneksi 42. Mjediset e Fakultetit AB</i>			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	Bazuar në dokumentacion, në fillim të vitit akademik, biblioteka pasurohet me tituj botimesh të reja në varësi të lëndëve të programit të studimit për literaturën bazë ose ndihmëse, sipas syllabusit. <i>Aneksi shtese 16. Plani per Biblioteken.</i>			
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Biblioteka mund të përdoret nga studentët pa kufizime gjatë orarit zyrtar që biblioteka qëndron e hapur (9.00-21.00). Biblioteka disponon vende të mjaftueshme për studentët dhe u ofron atyre mundësinë për të studjuar, për të përdorur literaturën mësimore bazë apo ndihmëse duke përdorur kompjuterat që biblioteka disponon ose kompjuterat personalë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ referuar rregullores së TBU, konstaton se të dhënat në TBU mbahen në regjistrat manualë dhe elektronik. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi mbajtjen e rregjistrave manual nga sekretaria mësimore në lidhje me studentët e programit. Referuar takimit të zhvilluar me stafin e burimeve njerëzore, rezultoi se zyra e burimeve njerëzore administrohet të dhënat dhe dokumentacionin për aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ. Këto të dhëna rezultuan të jenë kryesisht manuale.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e	Referuar takimit me studentët, rezultoi se studentët duhet të drejtohen në sekretarinë mësimore nëse kanë nevojë për informacion në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive. Gjatë takimit që GVJ pati në institucion, evidentoi se komunikimi dhe informacioni mund të jepet përveçse në prezencë fizike edhe nepermjet email ose në faqen eeb. Por nuk ka ende një sistem të brendshëm të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




programit.	menaxhimit të të dhënave. TBU është duke e testuar një sistem të tillë.			
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ sugjeron implementimin e një sistemi informacioni të integruar, për menaxhimin e data bazës për të dhënat e studentëve, për vlerësimet e tyre dhe që vetë studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre të kenë informacion në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respektive. Gjithashtu ky sistem informacioni mund të shërbejë për menaxhimin e gjithë data bazës në vite për stafin akademik, ndihmës akademik, personelit administrativ, duke nisur që prej procedurave të konkurrimit, seleksionit, rekrutimit, ndryshimet vit mbas viti etj.			
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Duke qenë se numri i stafit akademik, joakademik dhe i studentëve është i vogël, deri tani arrihet të monitorohet aktiviteti akademik e administrativ, por GVJ rekomandon implementimin e një sistemi të integruar të menaxhimit të informacionit, i cili garanton monitorim dhe siguron raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese, titullarët apo ekspertët e jashtëm.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Në këtë mënyrë institucioni do të siguronte një dokumentim dhe formalizim më të mirë të proceseve administrative, për të dëshmuar dhe gjurmuar proceset e realizuara, problem që u identifikua gjatë vizitës në institucion. Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU. Aneksi 9. Rregullore për sekretarinë mësimore. Aneksi shtese 19. Rregullore për arkivin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.6	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ, bazuar në RVB si edhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni konstaton se institucioni harton raport financiar të të ardhurave dhe kostove për programin e studimit Master profesional “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë. Ky raport është i përvitshëm sikurse edhe bëhet parashikimi për vitet pasardhëse. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare. Gjithashtu institucioni harton edhe një plan të financimit për programin e studimit i cili përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit i cili është vetëm nga tarifat e studimit dhe shpenzimet që janë për: personel akademik, personel jo akademik, qera dhe amortizim.
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e	Në planin financiar të pasqyruar nga institucioni nuk pasqyrohen dhe nuk parashikohen shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line etj.</p> <p>Institucioni në mbyllje të ciklit të studimit, harton raporte financiare për 3 vitet e fundit sikurse edhe harton dhe parashikon planin financiar për 5 vitet e ardhshme.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>				
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p><i>TBU RVB Programi Master Profesional AB_60.</i> <i>Aneksi 49. Te dhena nga raporti financiar vjetor.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>GVJ duke ju referuar RVB, si edhe të dhënave nga raporti financiar, konstaton një qëndrueshmëri financiare të institucionit. Kjo duke parë që shpenzimet për këtë program studimi, mbulohen totalisht nga të ardhurat e siguruara nga tarifat e studimit dhe madje parashikimi për 5 vitet e ardhshme tregon një rritjen e të ardhurave të siguruara nga ky program studimi.</p> <p><i>Aneksi 49. Te dhena nga raporti financiar vjetor</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	------------------------------	-------------------------------------	------------------------------------	---

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në përcaktimin e kriterëve pranues në programin Master profesional në “Administrim Biznesi” me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, institucioni ndjek të njëjtën praktikë që zbatohet edhe për programet e tjera të studimit. Procedurat dhe kriteret e pranimit në këtë program studimi, janë konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si dhe në përputhje me politikat e institucionit.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqërojnë studentin përgjatë programit. Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloren e institucionit si edhe në rregulloren e programit të studimit dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë përkatëse për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MASR) dhe janë në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të TBU. Shpallja e fituesve për këtë program studim bazohet në udhëzimet e MASR si përsa i përket afateve ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të TBU. <i>Aneksi 2. TBU_Statuti.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i> <i>Aneksi 7.Rregullore e programit të studimit mp_ab_60_final.</i>
Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	6 muaj para fillimit të vitit akademik, institucioni i dërgon për miratim MASR-së kuotat si edhe kriteret për programin e studimit. Kriteret e pranimit miratohen me vendim të Senatit Akademik të TBU, bazuar në propozimet e departamentit përgjegjës të programit dhe Fakultetit të Administrim Biznesit. Kriteret dhe kuotat, publikohen në faqen elektronike zyrtare të TBU. Nga takimi i GVJ me stafin akademik, pedagogët u shprehën se studentët njoftohen në rrugë zyrtare nëpërmjet publikimeve në faqen elektronike zyrtare të TBU dhe në rrjete sociale si edhe komunikime informale që pedagogët zhvillojnë me studentët në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik me studentët potencial për të ndjekur këtë program studimi. Në takimin që GVJ pati me drejtuesin e departamentit, por edhe me studentët e këtij programi studimi, u konstatua se përveç kriterit të mesatares për studentët aplikues, rëndësi ka edhe intervista që kandidatët bëjnë.
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Por gjithsesi GVJ, gjatë vizitës në institucion nuk evidentoi asnjë evidencë të dokumentuar për pjesën e intervistës që kandidatët bëjnë. <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i> <i>Aneksi 7.Rregullore e programit të studimit mp_ab_60_final.</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të dytë Master profesional në “Administrim Biznesi”, me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë, është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë diplomë Bachelor të shoqëruar me suplementin e diplomës, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentët me transferim.</p> <p>Nga takimi i GVJ me përgjegjës të departamentit përgjegjës për këtë program studimi, u konstatua se studentët e këtij programi studimi, informoheshin në mënyrë të vazhdueshme për programin e studimit, objektivat e tij si dhe kompetencat e pëfituara në përfundim të tij. Gjithashtu numri i vogël i studentëve, krijon mundësinë për komunikime të vazhdueshme me ta. Gjithshtu ç’do informacion në lidhje me programin e studimit jepet edhe në faqen ëeb të institucionit.</p> <p>Po kështu vënia në dispozicion të studentëve të syllabuseve si dhe kriteret për kalimin nga një vit në tjetrin plotësohet nga stafi i angazhuar në këtë program studimi dhe sekretaria mësimore. Nga sa më sipër GVJ konstaton që kriteret plotësohen, institucioni është i pajisur me strukturat përkatëse si dhe me procedurat e rregulluara dhe zbatuara nga strukturat përgjegjëse për këtë program studimi. Më konkretisht rregullorja e institucionit specifikon procedurat që ndiqen në rastin e njohjes së studimeve të mëparshme.</p> <p><i>Aneksi 7.Rregullore e programit të studimit mp_ab_60_final.</i> <i>Aneksi 47. Te dhena nga faqja zyrtare ëeb.</i> <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit, TBU.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p> <p><i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional 60 ect.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Studenti njoftohet në lidhje me procedurat e diplomimit, këto kriteret janë të detajuara te rregullorja e programit të studimit, si sa i përket peshës në kredite si dhe numrin e krediteve që studenti duhet të ketë para diplomimit. GVJ konstaton që për këtë program studimi, hartohen indikatorët të matshëm për vlerësimin e cilësisë së punimit të diplomës.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullore e programit të studimit mp_ab_60_final.</i> <i>Aneksi 10. Rregullore diplomimi.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p><i>Aneksi shtese 13. Model flete vleresues diplomim me teme.pdf</i> <i>Aneksi shtese 14. Model flete vleresues diplomim provim formimi.</i> <i>Aneksi shtese 12. Nje model kazusi provim formimi_MP_AB.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Programi i studimeve të ciklit të dytë Master profesional në “Administrim Biznesi”, me profile Menaxhim dhe Kontabilitet-Financë është program i hapur për të gjithë ata studentë që zotërojnë diplomë Bachelor, shqiptare ose të huaj, sipas standardit dhe rregullave të vendosura nga MASR, si dhe për studentët me transferim. Stafi akademik bën informimin e studentëve të nivelit bachelor që studjojnë pranë TBU për programin e studimit, objektivat, mundësitë e punësimit etj. I gjithë informacioni në lidhje me programin e studimit dhe gjithçka që lidhet me të, është publike në faqen ëeb të institucionit, sikurse herë pës herë behën njoftime në lidhje me të në rrjetet sociale.</p> <p><i>Aneksi 47. Te dhena nga faqja zyrtare ëeb.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

<p>Standardi V.3 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Studenti mund të terheqë planin mësimor, strukturën e moduleve dhe shpërndarjen në semestra pranë sekretaries. Ky informacion publikohet edhe në mediat sociale të TBU si edhe në faqen ëeb. Studentët informohen në vazhdimësi nga sekretaria mësimore për orarin e mësimave dhe ç’do njoftim tjetër që lidhet me procesin mësimor.</p> <p><i>Aneksi 9_ Rregullore për sekretarinë mësimore.</i> <i>Aneksi 47_ Te dhena nga faqja zyrtare ëeb.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ konfirmon se institucioni jep informacion, lidhur me programet e studimit, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik dhe ndihmës. Ky informacion gjithashtu gjendet edhe në faqen ëeb të institucionit.</p> <p><i>Aneksi 7. Rregullore e programit të studimit mp_ab_60_final.</i> <i>Aneksi 19 Syllabuset e Lendeve Master profesional 60 ects.</i> <i>Aneksi 47. Të dhëna nga faqja zyrtare ëeb.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni (Aneks 12), si edhe nga takimi që pati në institucion konfirmon se Zyra e Karrierës në TBU ka si objektiv informimin e vazhdueshëm të studentëve lidhur me mundësi për praktikë profesionale, punësim, aktivitete formuese, bursa studimi, konkurse, panairë, konferenca, forume, etj.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>Gjithshtu kjo zyrë, organizon seanca të trajnimit në grup dhe këshillim individual për procese të lidhura me orientimin dhe zhvillimin në karrierë (përgatitja për intervistë punë, hartimi i CV-së dhe Letrës së Motivimit, ndërtimi i një profili profesional në LinkedIn, etj.)</p> <p>Objektiv i kësaj zyrë është gjithashtu konceptimi, planifikimi dhe organizimi i aktiviteteve formuese (leksione, seminare, trajnime, etj) për tema që lidhen me përmirësimin e aftësive ndërpersonale, teknike, etj.</p> <p><i>Aneksi 12. Rregullore Zyra e Karrieres TBU.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Në takimin që GVJ pati në institucion, konstatoi se studentët e këtij programi studimi, informohen në mënyra të ndryshme për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, nëpërmjet stafit akademik, sekretarisë, mediat sociale si edhe faqe ëeb të TBU. Informimi i studentëve në lidhje me sallat e mësimi, bibliotekën e gjithçka tjetër që lidhet me realizimin e programit të studimit bëhet në fillim të vitit akademik.</p>			
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët nëpërmjet postës elektronike dhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të TBU. Megjithatë në RVB dhe dokumenta të tjerë të paraqitur nga institucioni nuk paraqiten evidence për sistem të brendshëm menaxhimi.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Institucioni disponon të dhëna për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet si dhe diplomimet në strukturat përkatëse. Këto të dhëna disponohen nga sekretaria mësimore e cila i percjell ato te koordinatori i programit të studimit dhe në zyrën e ALUMNI.</p> <p>Duke konsideruar se ky program ka filluar aktivitetin e tij në vitin akademik 2017-2018, pas ristrukturimit të masterit 90 kredite, nuk është e mundur që të ndërtohen raporte krahasuese mbi cilësinë e studentëve.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>S.3_Numri i studentëve në total dhe i ndarë sipas profileve për vitin akademik 19-20.</i>), viti akademik 2019-2020 rezultojnë te regjistruar 86 studentë (66 të profilit Menaxhim dhe 20 profilit Kontabilitet-Financë.) Mesatarja në hyrje është 7.65.</p> <p>Për ç’do student sekretaria mësimore disponon dosjet e studentëve, të cilat përbajnë të dhënat që nga rregjistrimi, ndjekja e studimeve deri në përfundim/diplomim të tyre.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ gjykon që mesatarja për këtë program studimi për vitin akademik</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve</p>	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	2019-2020 është më e larta ndër gjithë vitet për këtë program studimi duke treguar për një përmirësim të nivelit të studentëve të rregjistruar. Gjithashtu numri në rritje i studentëve të rregjistruar në këtë program studimi për vitin akademik 2019-2020 tregon për një atraktivitet që ky program studimi ka.			
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore menaxhohen kryesisht nga sekretaria mësimore, koordinatori i programit të studimit dhe zyra e ALUMNI si edhe Zyra e Karrierrës dhe Punësimit.			
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Departamenti përgjegjës i programit të studimit, në fund të ç'do viti akademik, harton raport në lidhje me analizën e përbushjes së objektivave të programit të studimit.			
	S.3_Numri i studentëve në total dhe i ndarë sipas profileve për vitin akademik 19-20. Aneksi 27. Cilesia ne hyrje dhe dalje studente MP_AB. Aneksi 38. Analize e realizimit te objektivave Programi Studimit Master Profesional 60 Ab_ 18-19.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të TBU sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtar me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: - Senatin Akademik të TBU; - Komisionin e Cilësisë në nivel institucional dhe njësie kryesore; - Komisione të përhershme si NJBSC;
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Gjithashtu TBU, nëpërmjet NJSBC, organizon pyetësorë për studentët për të bërë vlerësimin e ç'do lëndë dhe ç'do pedagogu për lëndët përkatëse. Në këtë proces anketimi, studentët janë të lirë të shprehin mendimin dhe opinionin e tyre në mënyrë anonime. Aneksi 30. Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilesise. Aneksi 40. Pyetesori i studenteve.
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të	Institucioni e ka parashikuar në rregulloren e institucionit ngarkesën e lejuar për të gjitha programet e studimit edhe ky program studimi

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>respekton të njëjtën rregullore.</p> <p>Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është në përputhje me aktet nënligjore (jo më tepër se 25 orë në javë) dhe parashikon 6 deri në 16 orë mësimore në javë në auditor. Për programet Master numri minimal i orëve mësimore që zhvillohen në auditor në një në ditë është 3 orë dhe maksimale 4 orë ndërsa numri i orëve mësimore në javë luhatet në intervalin 6-16 orë mësimore. Mësimi, si rregull, zhvillohet mbasdite.</p> <p>Njohja e krediteve nga studime të mëparshme zhvillohet nga komisioni i transferimeve i cili përcakton përputhshmërinë e tyre me lëndët e ofruara në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i> <i>Aneksi shtese 20. Shembull vendim ekuivalentimi MP_AB_60.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>TBU, nëpërmjet NJSBC-së, organizon pyetësorë për studentët për të bërë vlerësimin e ç’do lëndë dhe ç’do pedagogu per lëndët përkatëse. Në këtë proces anketimi, studentët janë të lirë të shprehin mendimin dhe opinionin e tyre dhe mbetën anonim. Rezultatet e pyetësorit merren në konsideratë dhe kontribuojnë në përmirësimin e mësimdhënies.</p> <p><i>Aneksi 40. Pyetesori i studenteve.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>TBU ka parashikuar në rregulloren e tij procedurën që siguron ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Këto rregullore janë aplikuar edhe në këtë program studimi.</p> <p><i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Institucioni është pajisur me struktura të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Sekretaria mësimorë është njëra prej njësive në institucion në shërbim të informimit të studentëve për procesin mësimor, orarin etj. Gjithashtu në TBU është funksionale edhe Zyra e Ç’ështëjeve Studentore dhe Këshillimit të Karrierës, si edhe Zyra e Alumnit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit</p>	<p>Zyra e ç’ështëjeve studentore dhe këshillimit të karrierës është përgjegjës për:</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	<ul style="list-style-type: none"> • procesin e këshillimit të karrierës; • ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve; • mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni; • krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për zhvillimin e praktikës së studentëve; • krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi punësimi për studentët; • organizon aktivitete për studentët; • organizon trajnime, seminare, Ëorkshop-e, etj; 			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	<p>Për programin e studimit Master profesional në “Administrim Biznesi”, me profile, në informimin e studentëve për mundësitë e punësimit, trajnimet dhe kontaktet me studentët e diplomuar, një rol të rëndësishëm luan edhe bashkëpunimi i ngushtë me biznesin. Punësimi i pjesës më të madhe të studentëve që kanë ndjekur këtë program studimi është një tregues suksesi për programin.</p>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	<p><i>Aneksi 9. Rregullore për sekretarinë mësimore.</i> <i>Aneksi 12. Rregullore Zyra e Karrieres TBU.</i> <i>Aneksi 29 Te dhena tabelore permbledhese per punesimin real te studenteve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e	Institucioni është i pajisur me strukturat që garantojnë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së brendshme duke përfshirë edhe këtë program studimi. Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>në përputhje të plotë të misionit të institucionit. NJSBC si strukturë, është e përcaktuar në Statutin e TBU. Kjo njësi ka për detyrë garantimin e cilësisë së brendshme të TBU dhe të programeve që ofrohen prej tij, në përputhje me standardet kombëtare. Komisionet e cilësisë janë ngritur në nivel institucional por edhe në nivel fakulteti.</p> <p><i>Aneksi 2. TBU Statuti, neni 27</i> <i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC.</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët. Monitorimi i sigurimit të cilësisë funksionon edhe në rang fakulteti. Kjo njësi monitoron kryesisht cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor.</p> <p><i>Aneksi 30. Të dhëna tabelore për sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> <i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC.</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>TBU përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL.</p> <p><i>Aneksi 18. Plotesimi i rekomandimeve nga akreditimi i meparshëm _MP_AB_60.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në dokumentin strategjik (<i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC</i>).</p> <p>GVJ duke u bazuar edhe në dokumentacionin shtesë të vënë në dispozicion nga institucioni <i>evidenton se NJSBC harton një plan kalendarik në të cilin parashikohet plani i veprimit, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse.</i></p> <p>Në mënyrë periodike NJSBC informon drejtuesit e njëjësive, e përmes tyre të gjithë stafin e TBU rreth rezultateve të monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njëjësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi VI.2 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>NJSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm përveç NJSBC-së ka dhe departamenti si njësi përgjegjëse për programin e studimit. Në këtë program studimi, një kontribut të rëndësishëm në monitorimin, mbikëqyrjen dhe rishikimin e programit të studimit ka dhe lidhja me biznesin.</p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit</p>	<p>Referuar RVB, TBU, përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese. Monitorimi i realizimit të programit realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, <i>NJSBC siguron vetëvlerësimin periodik të TBU dhe të programeve të tij. Vlerësimi nënkupton një proces sistematik të mbledhjes, rishikimit dhe përdorimit të të dhënave të rëndësishme sasiore dhe cilësore nga burime të shumta dhe të ndryshme rreth programeve arsimore, për qëllimin e përmirësimit të mesimnxenies së studenteve dhe vlerësimin nëse po përmbushen standardet akademike dhe të mesimnxenies.</i></p>			
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>GVJ bazuar në dukumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni por edhe nga takimi që pati me përfaqësues të NJSBC, evidentoi se treguesit e vetëm të përdorur për ecurinë e programit të studimit është nota mesatare dhe kalueshmëria, sikurse edhe punësimi i studentëve në total dhe punësimi i studentëve sipas profilit të studimit. Instrumenti i vetëm i përdorur prej NJSBC-së është pyetësori për studentët për vlerësimin e pedagogut të lëndës dhe pyetësori për stafin akademik.</p>			
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Aktivitetet me karakter monitorues dhe vlerësues që organizohen nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që monitorohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Dekanëve të fakulteteve dhe përgjegjësve të departamentit.</p> <p>GVJ, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit por edhe gjatë vizitës në institucion, nuk evidentoi ndonjë raport në lidhje programin e studimit në lidhje me rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit si edhe masat e marra. Përmbledhja e vetme në dokumentacion në lidhje me këtë është vlerësimi mesatar për secilin pedagog të lëndëve nga ana e studentëve.</p> <p><i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC</i> <i>Aneksi 40. Pyetësori i studenteve.</i> <i>Aneksi 41. Pyetësori i stafit akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi VI.3
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga Departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike. Këto vlerësime janë pjesë e vetëvlerësimeve në kuadër të akreditimit.</p>			
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Për kryerjen e vlerësimit dhe monitorimit të programit Master profesional në “Administrim Biznesi” me profile, strukturat përgjegjëse përdorin instrumenta të përdorur edhe në programe të tjerë studimi në TBU.</p> <p>Të dhënat që ofrohen nga sekretaria mësimore janë kryesisht për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, monitorimin e realizimit të mësimin.</p> <p>Ndërkohë që kryhet edhe anketimi i studentëve dhe personelit akademik në nivel institucioni, njësie kryesore dhe në nivel të këtij program studimi.</p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Megjithatë në RVB thuhet se NJBSC kryen vlerësime për mësimdhënien, vlerësime për kurrikulën etj, por nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni si edhe nga takimi që GVJ pati me përfaqësues të NJBSC, nuk evidentoi asnjë raport në lidhje me vlerësimet e tjera përveç pyetësorëve ndaj studentëve dhe stafit akademik.</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p><i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC</i> <i>Aneksi 40. Pyetëtori i studenteve.</i> <i>Aneksi 41. Pyetëtor stafi akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së</p>	<p>Nuk</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




standardit	përmbushet	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X	

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni përfshin aktorë të brendshëm në vlerësimin e programit, stafin që lidhet me direkt me programin e studimit në fjalë, sikurse edhe student në strukturën e NJSBC. <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Përgjegjësitë dhe detyrat që duhet të ushtrohen nga secili prej anëtarëve të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë janë të përcaktuara qartë në kryerjen e funksioneve dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara në rregulloren e kësaj njësie. Bazuar në rregullore NJSBC, siguron vetëvlerësimin periodik të TBU dhe të programeve të tij dhe të gjithë anëtarët e këtij grupi duhet të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë për realizimin e vetëvlerësimit. <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	Në institucion janë të përcaktuar qartë njësitë që janë përgjegjëse për programin e studimit (Aneksi 36). Koordinator i programit shërben si një urë lidhëse midis biznesit dhe njësisë përgjegjëse për këtë program studimi. Po kështu kontaktet e vazhdueshme me studentët bëjnë që të gjitha palët të marrin pjesë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit dhe përshtatjes së tij me nevojat më të fundit të tregut. <i>Aneksi 36_Vendim për emerimin e koordinatorëve të programeve MP_AB.</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Institucioni përfshin aktorë të brendshëm në vlerësimin e programit, stafin që lidhet me direkt me programin e studimit në fjalë, sikurse edhe student në strukturën e NJSBC, duke shmangur gjithashtu diskriminimin apo pabarazinë ndërmjet tyre. <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	Bazuar në dokumentacion, pjesë aktive e procesit të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm janë stafi akademik dhe studentët. Për këtë proces nuk ka bashkëpunëtorë apo ekspertë të jashtëm. Në RVB, sikurse edhe në takimin që GVJ pati me përgjegjësin e departamentit përgjegjës për këtë program studimi, u evidentua që herë pas here ftoheshin përfaqësues dhe drejtues të biznesit për leksione të hapura. <i>Megjithatë GVJ nuk evidentoi ndonjë ndryshim apo përmirësim në cilësinë e programit si pasojë e mendimeve të ekspertëve të jashtëm.</i>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5				
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Institucioni është i pajisur me strukturat përgjegjëse që sigurojnë monitorimin e vazhdueshëm të cilësië. GVJ gjykon që krahas rregullore së NJSBC-së, institucioni ka hartuar edhe një plan pune sipas një plani kalendarik (planit të veprimit) të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. <i>Aneksi 8_Rrregullore e NJSBC.</i>			
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni publikon rezultatet si është parashikuar në rregullore. Kështu sa i përket pyetësorëve të realizuar me studentët, rezultatet e vlerësimit i vihen në dispozicion individualisht, të gjithë anëtarëve të stafit akademik të vlerësuar, përgjegjësive të departamentit, si dhe dekanëve përkatës sikurse edhe Rektorit. <i>Aneksi 5. Rregullore e Institucionit TBU.</i> <i>Aneksi 8. Rrregullore e NJSBC.</i>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	Bazuar në RVB, sikurse edhe në takimin që GVJ pati me përfaqësues të NJSBC, evidentoi se në rast të vlerësimeve negative, synohet shqyrtimi i tyre dhe marrja e masave për përmirësim. Synimi i vazhdueshëm i TBU, është efektiviteti i veprimtarivë në kuadër të përmirësimin të cilësisë si edhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së programit të studimit. Në RVB theksohet se TBU organizon veprimtari periodike për informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe që në këto veprimtari marin pjesë edhe përfaqësi nga studentët. Por GVJ, në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në vizitën në institucion nuk evidentoi ndonjë evidencë në lidhje me këtë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Nr. 219, Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Nr. 219, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Administrim Biznesi me profile: a. Menaxhim; b. Kontabilitet - Financë” të institucionit të Arsimit të Lartë “TBU”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Marrëveshje bashkëpunimi me një numër të madh biznesesh jo vetëm për kryerjen e praktikës profesionale por edhe për punësimin e studentëve.
2. Infrastruktura e ofruar nga TBU siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike. Infrastruktura është e përshtatshme dhe pajisur me salla leksioni dhe seminari, laboratore dhe bibliotekë.
3. Stafi akademik i TBU është i kualifikuar, me eksperiencë dhe me eksperiencë profesionale në fushat përkatëse të mësimdhënies.
4. Pjesëmarrja e TBU në projekte dhe angazhimi i studentëve në to krijon mundësinë e kualifikimit të stafit akademik por edhe forcon frymën e bashkëpunimit midis stafit dhe studentëve.
5. Programi i studimit Master profesional, “Administrim Biznesi” me profilin Kontabilitet-Financë synon në përgatitjen për një kohë të shkurtër, pra për një vit të profesionistëve në këtë fushë.

Pika të dobta

1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në këtë program studimi nuk përmbush kërkesat ligjore në fuqi, më konkretisht pikës 6 të nenit 59 të ligjit 80/2015, ku thuhet se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të ketë të paktën kualifikimin e ciklit pasardhës. Për vitin akademik 2019-2020, nga stafi akademik PAE dhe PAK, i angazhuar për programin e studimit, 16 janë më titullin Msc.
2. Nuk ka një analizë të tregut mbështetur në kërkesat dhe pritshmëritë e bizneseve apo në opinionin e bizneseve dhe studentëve të diplomuar se çfarë ata shohin vështirësi në tregun e punës bazuar në programin e studimit që ata kanë përfunduar.
3. Plani mësimor nuk është i specifikuar sipas krediteve për të gjitha veprimtaritë formuese (leksione, seminare, detyra kursi, projekte etj) por shprehet vetëm në orë mësimore.
4. Plani mësimor nuk është i balancuar, ka shumë orë studim individual krahasuar me orët në auditor të studentit.



5. Vlerësimi i vazhdueshëm i studentit si edhe vlerësimi final i lëndës paraqitur në syllabuset e lëndëve nuk bëhet plotësisht konform akteve nënligjore, rregullores së institucionit si edhe rregullores së programit të studimit.
6. Mungesa e një sistemi informacioni të integruar, për menaxhimin e data bazës për të dhënat e studentëve dhe stafit.

Rekomandime

1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme i rekrutuar, që angazhohet në këtë program studimi duhet të plotësojë kërkesat ligjore në fuqi, më konkretisht pikës 6 të nenit 59 të ligjit 80/2015, ku thuhet se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie duhet të këtë të paktën kualifikimin e ciklit pasardhës.
2. Plani mësimor në të ardhmen, t'i nënshtrohet në mënyrë të vazhdueshme përmirësimeve, me qëllimin e përputhshmërisë me aktet nënligjore por edhe me kërkesat e një tregu pune dinamik si dhe për të reflektuar edhe rekomandime të ekspertëve të jashtëm, apo të studentëve si dhe të bizneseve partnere. Plani mësimor duhet të përfshijë me kreditet përkatëse të gjitha veprimtaritë formuese të cilat janë në syllabuse por mungojnë në planin mësimor.
3. Ngarkesa e programit të studimit duhet rishikuar për të balancuar orët në auditor dhe jashtë auditorit.
4. Vlerësimi i vazhdueshëm i studentit si edhe vlerësimi final i lëndës paraqitur në syllabuset e lëndëve duhet të bëhet konform akteve nënligjore, rregullores së institucionit si edhe rregullores së programit të studimit.
5. NJSBC duhet të hartojë, në mënyrë të posaçme dhe të detajuar për gjithë aktivitetin e vet, mekanizmat e përdorur dhe identifikimin e praktikave të mira ose problematikave dhe të propozojë dhe adresojë zgjidhje për to.
6. Institucioni duhet të përmirësojë ndjeshëm dokumentimin e vazhduar të proceseve të realizuara për përmirësimin e cilësisë.
7. Implementimin e një sistemi informacioni të integruar, për menaxhimin e data bazës për të dhënat e studentëve, për vlerësimet e tyre dhe që vetë studentët nëpërmjet kredencialeve të tyre të kenë informacion në lidhje me progresin dhe vlerësimet e tyre në lëndët respective. Gjithashtu ky system informacioni mund të shërbejë për manaxhimin e gjithë data bazës në vite për stafin akademik, ndihmës akademik, personelit administrative, duke nisur që prej procedurave të konkurrimit, seleksionit, rekrutimit, ndryshimet vit mbas viti etj.



Evaluation conclusions on 1 Year Professional Program in Business Administration (60 Ects), offered by the "Tirana Business University"

Strengths and affirmations

1. Cooperation agreements with a large number of businesses not only for professional practice but also for student employment.
2. The infrastructure provided by TBU provides sufficient and appropriate learning environments for the development of theoretical teaching activity. The infrastructure is adequate and equipped with lecture and seminar rooms, laboratories and library.
3. The academic staff of TBU is qualified, experienced and with professional experience in the respective fields of teaching.
4. The participation of TBU in projects and the engagement of students in them creates the opportunity for the qualification of the academic staff but also strengthens the spirit of cooperation between the staff and the students.
5. The professional master study program, "Business Administration" with the profile Accounting-Finance aims at preparing for a short time, ie for one year of professionals in this field.

Weaknesses

1. Full-time and part-time academic staff engaged in this study program does not meet the legal requirements in force, more specifically point 6 of article 59 of law 80/2015, which states that academic staff engaged in teaching must have at least the qualification of the next cycle. For the academic year 2019-2020, from the academic staff PAE and PAK, committed to the study program, 16 are with the title Msc.
2. There is no market analysis based on the demands and expectations of businesses or the opinion of businesses and graduate students on what they see as difficulties in the job market based on the study program they have completed.
3. The curriculum is not specified according to credits for all formative activities (lectures, seminars, course assignments, projects, etc.) but is expressed only in lessons.
4. The curriculum is not balanced, there are many hours of individual study compared to the hours in the student auditorium.
5. The continuous evaluation of the student as well as the final evaluation of the course presented in the syllabus of the courses is not done in full conformity with the bylaws, the regulation of the institution as well as the regulation of the study program.
6. Lack of an integrated information system for managing the database of student and staff data.

Recommendations:

1. Full-time and part-time academic staff recruited to engage in this study program must meet the legal requirements, more specifically point 6 of article 59 of law 80/2015, which states

Adresa: "Rruga e Durrësit"

Nr. 219, Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



that academic staff engaged in teaching must to have at least the qualification of the next cycle.

2. The curriculum in the future, to be continuously subject to improvements, with the aim of compliance with bylaws but also with the requirements of a dynamic labor market and to reflect the recommendations of external experts, students or partner businesses. The curriculum should include with appropriate credits all formative activities which are in syllabuses but are missing in the curriculum.
3. The work program load should be reviewed to balance the hours in the auditorium and out of the auditorium.
4. The continuous evaluation of the student as well as the final evaluation of the course presented in the course syllabus must be done in accordance with the bylaws, the regulation of the institution as well as the regulation of the study program.
5. The Internal Quality Assurance Unit should design, in a special and detailed way for all its activity, the mechanisms used and the identification of good practices or problems and to propose and address solutions for them.
6. The institution should significantly improve the continuous documentation of the implemented processes for quality improvement.
7. Implementation of an integrated information system, for the management of the database for student data, for their evaluations and for the students themselves through their credentials to have information about their progress and evaluations in the respective subjects. Also, this information system can serve for the management of the entire database in years for academic staff, academic assistants, administrative staff, starting from the competition procedures, selection, recruitment, changes year after year, etc.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE			X	
VLERËSIMI TËRËSOR			X	


